

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5500  
E martë, 12 qershor 2018  
çmimi 0.40 €

Veseli inicion  
Projektligjin për  
mbrojtjen e vlerave të  
luftës së UÇK-së



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## AKTUALE

**HISTORIA E  
BISEDIMEVE  
POLITIKE NË MES  
TË PRISHTINËS  
DHE BEOGRADIT**



F. 11  
Jakup KRASNIQI

**KOSOVA NGRE LAPIDAR PËR  
USHTARËT E NATO-S DHE TË  
KFOR-it TË RËNË NË SHËRBIM**

F. 6

**KËRKOHEP PUNË NGA  
MINISTRAT PËR ZBATIMIN E  
AGJENDËS EVROPIANE**

F. 3

## EKONOMI

**TAHIRI: DO TË KONFISKOHEN  
PASURITË E FITUARA  
JASHTËLIGJSHËM**

F. 9

**BIE KOSTOJA E NDËRTIMIT  
NË KOSOVË**

F. 8

## KULTURË

**VARGJET GRI**

F. 13

Kosovare KRASNIQI

## SPORT

**MKRS-ja NUK E HARRON  
SPORTIN E SUHAREKËS**

F. 20

**HARADINAJ VIZITON  
FAMILJARËT E VOKRRIT**

F. 20

FLET PËR "EPOKËN E RE", ALI BERISHA

## Qeverisja në Pejë ka degraduar



Ali Berisha, pas rikthimit në postin e kryetarit të Degës së Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në Pejë, ka vlerësuar se qeverisja në këtë komunë nuk është duke punuar për përmirësimin e jetës së qytetarëve. Ai ka thënë se kjo qeverisje ka degraduar në shumicën e aspekteve. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Berisha ka deklaruar se koalicioni qeverisës në Pejë nuk është duke i realizuar premtimet që i ka dhënë në fushatën elektorale. Sipas tij, një prej projekteve më të rëndësishme për të ardhmen e Pejës, "Borea", ende nuk ka filluar të realizohet. Berisha ka premtuar se me rikthimin e tij Dega e Aleancës në Pejë do të ristrukturohet, do të fuqizohet dhe do të jetë pretendentja kryesore për t'i fituar zgjedhjet. Ai nuk e ka përjashtuar mundësinë që në zgjedhjet e ardhshme komunale të jetë kandidat për kryetar të Komunës së Pejës

TË HËNËN KA NISUR NDËRTIMI I PIKËS SË PËRBASHKËT  
KUFITARE NË MES TË KOSOVËS DHE MAQEDONISË,  
BELLANOC - STANÇIQ

## Hoxhaj: Kufijtë e Kosovës janë të paprekshëm dhe të pandryshuar

Me rastin e vënies së gurit të themelit të pikës kufitare Bellanicë - Stançiq, zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver

Hoxhaj, ka thënë se hartat politike në Ballkan dhe kufijtë historikisht në këta dy-tre mijë vjetët e fundit janë bërë dhe



ribërë, por kufijtë e sotëm të Republikës së Kosovës janë të paprekshëm, të pandryshuar dhe të pacenuar

## Gjykata Kushtetuese ia lejon Haradinajt rritjen e pagës

Gjykata Kushtetuese ka marrë vendim që rritja e pagave për kabinetin qeveritar nga kryeministri Ramush Haradinaj nuk është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës



**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Curez-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**SatStyro**  
Mushnikovë-Prizren-Kosovë  
Product of EPS and XPS  
Mob.: +377(0) 44 506 815  
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030  
e-mail: [sat\\_styro@yahoo.com](mailto:sat_styro@yahoo.com)  
[www.satstyro.com](http://www.satstyro.com)

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



## Besoj fuqishëm për hapjen e negociatave

TIRANË, 11 QERSHOR - "Besojmë fuqimisht se në fund të këtij muaji Këshilli i Bashkimit Evropian do t'i hapë një perspektivë të qartë Shqipërisë". Kështu deklaroi të hënën ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, Ditmir Bushati, i cili iu përgjigj kërkesës së një grupi studentësh për zhvillimin e një interpelance me temë "Negociatat për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe perspektiva evropiane e

Shqipërisë". Pak ditë nga vendimi i rëndësishëm i Këshillit të Ministrave të BE-së për hapjen e negociatave për Shqipërinë, ministri Bushati foli për përfitimet nga ky proces dhe perspektivën evropiane të Shqipërisë. Bushati theksoi se hapja e negociatave është një proces vendimtar për trajektoren e modernizimit të Shqipërisë. Shqipëria, tha ai, është gatë për t'u ulur në tryezën e bised-

imeve për anëtarësim në Bashkimin Evropian, pasi ka përmbushur të gjitha detyrimet për këtë fazë të procesit. "Ne synojmë të ulemi në tryezën e bisedimeve dhe të hapim një kapitull të ri në marrëdhëniet me BE-në, që nuk do të mbyllet nesër, por do të ketë përpara sfida", tha Bushati. Ulja në tryezën e bisedimeve me vendet e BE-së, sipas Bushatit, është kartëvizita më e mirë për Shqipërinë.



Të hënën ka nisur ndërtimi i pikës së përbashkët kufitare në mes të Kosovës dhe Maqedonisë, Bellanoc-Stançiq

## Hoxhaj: Kufijtë e Kosovës janë të paprekshëm dhe të pandryshuar

Me rastin e vënies së gurit të themelit të pikës kufitare Bellanoc - Stançiq, zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka thënë se hartat politike në Ballkan dhe kufijtë historikisht në këta dy-tre mijë vjetët e fundit janë bërë dhe ribërë, por kufijtë e sotëm të Republikës së Kosovës janë të paprekshëm, të pandryshuar dhe të pacenuar



EPOKA E RE

Faton DERMAKU

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Zëvendëskryeministri i Republikës së Kosovës, Enver Hoxhaj dhe zëvendëskryeministri i Maqedonisë, Bujar Osmani, kanë vënë të hënën gurthemelin e pikës së përbashkët kufitare në mes të Kosovës dhe Maqedonisë, Bellanoc-Stançiq. Me këtë rast, zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka thënë se ka pasur vonesa për ndërtimin e kësaj pike kufitare me Maqedoninë, por më në fund ky projekt po realizohet duke zvogëluar dukshëm rrugën që banorët e këtyre zonave bënin në të kaluarën. "Ka qenë një pritje, një shpresë, ëndërr, të cilët qytetarët e të dyja komunave dhe vendeve e kanë pritur me padurim dhe sot po e shndërrojmë këtë ëndërr në realitet të ri. Falënderoj shumë njerëz, personalitete që kanë dhënë kontribut të madh për jetësimin e këtij projekti, pikës

kufitare, por dua të them një vlerësim personal. Është një temë që më ka përcjell nga viti 2011, nuk ka pasur takim me delegacionet e Maqedonisë që nuk kanë pasur temë të bisedës sonë që të jetësohet ky projekt, sidomos nga viti 2013, kur e kemi nënshkruar marrëveshjen për hapjen e kësaj pike kufitare ndërmjet dy vendeve tona", ka thënë Hoxhaj. Ai me këtë rast ka porositur se kufijtë e shtetit të Kosovës janë të paprekshëm dhe të pacenueshëm. "Hartat politike në Ballkan dhe kufijtë historikisht në këta dy-tre mijë vjetët e fundit janë bërë dhe ribërë, por ne kemi qëndruar këtu si popull dhe kufijtë e sotëm të Republikës së Kosovës janë të paprekshëm, të pandryshuar dhe të pacenuar", ka thënë Hoxhaj.

Edhe zëvendëskryeministri i Maqedonisë, Bujar Osmani, tha se ndërtimi i kësaj pike kufitare ka dimension të rëndësishëm në raportet ndërmjet dy shteteve, projektet e të cilave vetëm se po zgjerohen dhe një komunikim

pa barriera ndërmjet shqiptarëve nga të dyja anët e kufirit. "Ky projekt ka një domethënie krejtësisht tjetër për popullatën lokale të Likovës në Maqedoni, si dhe të Gjilanit në Kosovë, por në përgjithësi ka një domethënie të rëndësishme për tërë popullatën e kësaj ane. Ky vendkalim do ta lehtësojë qarkullimin e qytetarëve të këtyre komunave dhe komunave fqinje, gjë që është parakusht për rritjen e shkëmbimit ekonomiko-tregtar mes këtyre zonave, potencial i fuqishëm për të bërë biznes e për të siguruar mirëqenie dhe pros-

peritet ekonomik", tha Osmani. Kjo është pika e tretë e përbashkët ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë, por ajo e cila dallon këtë pikë është se ndërtohet në konceptin e menaxhimit të integruar të kufirit, me një pikë të përbashkët kufitare, e cila hyn në kategorinë e pikës A që nënkupton edhe për mallra dhe udhëtarë. Shefja e Zyrës së BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, deklaroi se hapja e pikës së re kufitare në Stançiq tregon punën e përbashkët të dyja vendeve, Kosovës dhe Maqedonisë, në

rrugën e tyre drejt integriteteve evropiane. "Shpresoj se do të vazhdoni të punoni bashkërisht për implementimin e punëve dhe më tej për kooperimin e arritjeve të synimeve për të mirën e qytetarëve të të dy vendeve dhe të gjithë rajonit", ka thënë Apostolova. Shefi i delegacionit të BE-së në Shkup, ambasadori Samuel Zbogar, ka thënë se kjo pikë kufitare do të ketë ndikim pozitiv për zhvillimin ekonomik të banorëve të zonave lokale ndërmjet dy vendeve, por edhe për stabilitetin politik të rajonit të gjerë.

## Basha mbledh grupin parlamentar dhe aleatët

TIRANË, 11 QERSHOR - Në kuadër të vijimit të aksionit opozitar, kreu i PD-së, Lulzim Basha, ka mbledhur grupin parlamentar, ku kanë marrë pjesë edhe aleatët. Pritet të merret një vendim në lidhje me mënyrën se si do të protestojë

opozita. Kujtojmë se javët e fundit deputetët e minorancës kanë marrë pjesë në komisionet parlamentare, por nuk kanë diskutuar për rendin e ditës, vetëm për çështjen "Xhafaj". Ndërsa gjatë seancës opozita ka

bllokuar foltoren duke mos lejuar vijimësinë normale. Për disa javë rresht Ruçi ka mbyllur punimet para kohe, ndërsa opozitarët kanë vijuar të flasin duke transmetuar fjalimet përmes rrjeteve sociale.





Mbahet takimi i rregullt i Këshillit Ministror për Integrim Evropian i dedikuar për zbatimin e Agjendës së Reformave Evropiane (ERA)

## Kërkohet punë nga ministrat për zbatimin e agjendës evropiane

Kryeministri Ramush Haradinaj ka kërkuar të hënën nga ministrat e tij të angazhohen më shumë për obligimet e papërbushura për Agjendën e Reformave Evropiane që ato t'i përfundojnë me kohë. Ai ka theksuar se agjenda evropiane është interes strategjik i vendit për faktin se ndërlidhet me liberalizimin e vizave



Evropian për të gjitha sfidat, ngecjet dhe në çfarë afati kohor planifikojnë t'i realizojnë obligimet. "Jam i vetëdijshëm që duhet bashkëpunim i ngushtë me Kuvendin e Kosovës, në mënyrë që të ecim përpara për përbushjen e tërësishme të të gjitha prioritetëve, veçanërisht kur kemi parasysh agjendën legislative", është shprehur Haradinaj, duke shtuar se agjenda evropiane është interes strategjik i Kosovës që ndërlidhet me liberalizimin e vizave.

Ndërkaq ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, e cila ishte nikoqire e këtij takimi, ka theksuar se është koha e fundit që të fokusohemi në përbushjen e obligimeve që dalin nga ERA. Ajo ka numëruar të gjitha detyrat që i presin ministratë përkatësi me agjendën evropiane. Pas përfundimit të takimit kryeministri Ramush Haradinaj, së bashku me ministrat e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, në një konferencë për media për gazetarë ritheksuan edhe një herë vendosmërinë e institucioneve për t'i kryer të gjitha detyrimet e papërbushura. "Ishte ndjenjë e mirë me qenë në një takim ku raportimi është i saktë dhe flitet për tema konkrete, jepen afatet kohore. Kjo është një dëshmi që Agjenda Evropiane respektohet në të gjitha nivelet e qeverisjes", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke shtuar se është rënë dakord edhe për një takim të këtij niveli kah fundi i këtij muaji.

**EPOKA E RE** **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 11 QERSHOR - "Ministrat duhet të angazhohen që obligimet e papërbushura për Agjendën e Reformave Evropiane t'i përfundojnë në kohë, duke shtuar të gjitha veprimet e nevojshme", kështu ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj në takimin e rregullt të Këshillit Ministror për

Integrim Evropian i dedikuar për zbatimin e Agjendës së Reformave Evropiane (ERA), i organizuar nga Ministria e Integritimit Evropian. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj ka thënë se janë në prag të vendimeve të rëndësishme, siç është liberalizimi i vizave dhe ua rikujtoi detyrat që institucionet përkatëse i kanë nga agjenda evropiane. "Synimi strategjik i Qeverisë është përbushja e

kritereve për ta marrë statusin e kandidatit për anëtarësim në Bashkim Evropian dhe ne jemi të përkushtuar që kjo të përfundojë me kohë", ka thënë kryeministri Haradinaj. Ai ka shtuar se implementimi efikas i detyrimeve që dalin nga kontrata me BE-në, që është Marrëveshja e Stabilizimit Asocimit, do të jetë themel i anëtarësimit të Kosovës në BE dhe heqjes së regjimit të vizave

për qytetarët. Kryeministri Haradinaj ka theksuar se duhen trajtuar me prioritet të shtuar të gjitha ngecjet që adresohen në raportin për vendin. "Të kemi kujdes që të implementohen saktë dhe qartë të gjitha rekomandimet e mbështetura në të dhënat konkrete", ka thënë ai. Kryeministri Haradinaj ka thënë se ministrat duhet ta njoftojnë Këshillin Ministror për Integrim

## Veseli inicicion Projektligjin për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së

PRISHTINË, 11 QERSHOR (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka iniciuar Projektligjin për mbrojtjen e vlerave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Ai ka thënë se me miratimin e këtij projektligji do të përcaktohej një datë e veçantë për ta përkujtuar sakrificën e popullit tonë për lirinë. "Në prag të shënimit të 19-vjetorit të përfundimit të luftës në Kosovë, sot iniciova Draftligjin për mbrojtjen e vlerave të luftës së Ushtrisë Çlir-

imtare të Kosovës. Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen institucionale të luftës sonë, ta përcaktojë monumentin qendror që i mungon vendit tonë, si dhe do ta nisë themelimin e muzeut të luftës së popullit tonë për çlirim. Po ashtu, me miratimin e këtij ligji do të përcaktohej një datë e veçantë për ta përkujtuar sakrificën e popullit tonë për lirinë, ndër dekada e shekuj, ashtu siç është praktikë në shumë vende", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".





Flet për "Epokën e re", Ali Berisha

# Qeverisja në Pejë



Ali Berisha, pas rikthimit në postin e kryetarit të Degës së Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në Pejë, ka vlerësuar se qeverisja në këtë komunë nuk është duke punuar për përmirësimin e jetës së qytetarëve. Ai ka thënë se kjo qeverisje ka degraduar në shumicën e aspekteve. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Berisha ka deklaruar se koalicioni qeverisës në Pejë nuk është duke i realizuar premtimet që i ka dhënë në fushatën elektorale. Sipas tij, një prej projekteve më të rëndësishme për të ardhmen e Pejës, "Borea", ende nuk ka filluar të realizohet. Berisha ka premtuar se me rikthimin e tij Dega e Aleancës në Pejë do të ristrukturohet, do të fuqizohet dhe do të jetë pretendentja kryesore për t'i fituar zgjedhjet. Ai nuk e ka përjashtuar mundësinë që në zgjedhjet e ardhshme komunale të jetë kandidat për kryetar të Komunës së Pejës

**EPOKA E RE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Kryetari i Degës së Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në Pejë, Ali Berisha, ka bërë me dije se është rikthyer në krye të kësaj dege për të ristrukturuar dhe fuqizuar atë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se Dega e Aleancës në Pejë do të jetë pretendentja kryesore për t'i fituar zgjedhjet e ardhshme. "Duke

pasur për bazë punën që duhet bërë në Degën e Aleancës në Pejë si dhe duke pasur parasysh se kjo është një prej degëve më të fuqishme të AAK-së në nivel të Kosovës, është vendosur të vazhdohet me njerëz me përvojë në mënyrë që dega të ristrukturohet, të bëhet një kombinim në mes atyre me përvojë dhe të rinjve me qëllimin e vetëm që kjo degë të jetë fituese në zgjedhjet e ardhshme", është shprehur Berisha.

Ai ka thënë se Aleanca në Pejë

ka strukturë dhe kapacitete. Berisha ka theksuar se AAK-ja në Pejë do të jetë opozitë e fuqishme dhe konstruktive ndaj qeverisjes aktuale. "Do të jemi opozitë që do ta ngrehim zërin ndaj dobësive dhe të këqijave në mënyrë që qytetarët e Pejës ta kenë një qeverisje më të mirë", ka theksuar Berisha. Ai ka vlerësuar se qeverisja në këtë komunë nuk është duke punuar për përmirësimin e jetës së qytetarëve. Madje, sipas Berishës, kjo qev-

erisje ka degraduar në shumicën e aspekteve. "Peja ka qenë qyteti më i pastër në Kosovë, kurse sot nuk është i tillë. Peja ka qenë destinacion i turizmit, sot nuk është. Ka shumë ndërtime pa leje, nuk është bërë zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit në fshatra, si dhe një pjesë e qytetit ka problem me ujërat e zeza", ka deklaruar ai, duke shtuar se koalicioni qeverisës nuk është duke i realizuar premtimet që i ka dhënë në fushatën elektorale. Sipas Berishës, një prej projekteve më të rëndësishme për të ardhmen e Pejës, "Borea", ende nuk ka filluar të realizohet.

**"Epoka e re":** Z. Berisha, pse vendoset të riktheheni në krye të Degës së Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në Pejë?

**Berisha:** Duke pasur për bazë punën që duhet bërë në Degën e Aleancës në Pejë si dhe duke

pasur parasysh se kjo është një prej degëve më të fuqishme të AAK-së në nivel të Kosovës, është vendosur të vazhdohet me njerëz me përvojë në mënyrë që dega të ristrukturohet, të bëhet një kombinim në mes të atyre me përvojë dhe të rinjve me qëllimin e vetëm që kjo degë të jetë fituese në zgjedhjet e ardhshme. Pas konsultimeve në mes të strukturave të degës dhe strukturave në nivelin qendror është vendosur që unë të kthehem dhe të kandidoj për kryetar të Degës së AAK-së në Pejë. Është mbajtur kuvendi zgjedhor i degës, ku janë zgjedhur strukturat drejtuese dhe kryetari. Për katër vjetët e ardhshëm unë do të jem kryetar i Degës së Aleancës në Pejë.

**"Epoka e re":** Si do ta rikuperoni humbjen e Aleancës në dy palë zgjedhje të njëpasnjëshme?

**Berisha:** Nuk kemi fituar në dy palë zgjedhje, por në dy

# Ka degraduar

mandatet paraprake kemi qenë në qeverisje. I kemi humbur zgjedhjet e fundit bazuar në disa kalkulime joparimore që janë bërë në Degën e Aleancës në Pejë si dhe për shkak të disa koalicioneve joparimore që kanë ekzistuar në komunë. Mirëpo, kësaj radhe do të organizohemi të mos na befasojnë as mekanizmat joparimorë. Do t'i rrisim kapacitetet dhe besoj se do ta kemi mbështetjen e nivelit qendror për rristurimin e degës. Aleanca në Pejë ka qenë pesë herë fituese e zgjedhjeve, dy herë e zgjedhjeve lokale dhe tri herë e zgjedhjeve nacionale. Prandaj, kemi strukturë, kemi kapacitete dhe do ta mobilizojmë degën, do ta funksionalizojmë këshillin profesional, si dhe do të jemi opozitë e fuqishme dhe konstruktive ndaj qeverisjes aktuale. Do të jemi opozitë që do ta ngrehim zërin ndaj dobësive dhe të këqijave në mënyrë që qytetarët e Pejës ta kenë një qeverisje më të mirë.

**"Epoka e re":** Do të jeni kandidat i Aleancës për kryetar të Komunës së Pejës?

**Berisha:** Është herët të flitet për këtë çështje. Tash për tash detyrë kryesore kemi riorganizimin, rristurimin dhe ngritjen e të gjitha kapaciteteve të degës, shtrirjen më të fuqishme në terren si dhe funksionalizimin e të gjitha nëndegëve që dikur i kishte

Aleanca në Pejë. Mirëpo, kurdo që të jetë koha e nevojshme do ta kemi edhe kandidaturën për kryetar të Komunës së Pejës që nuk do të thotë se do të jem unë, por do të jetë ai që do t'i fitojë zgjedhjet.

**"Epoka e re":** Por nuk përjashtohet mundësia që ju të jeni kandidat?

**Berisha:** Asgjë nuk përjashtohet. Do të jetë njeriu adekuat për t'i fituar zgjedhjet.

**"Epoka e re":** Pse jeni kaq i bindur se kandidati i Aleancës do të jetë fitues?

**Berisha:** Këtë e bazoj në nevojën aktuale, në rristurimin dhe mobilizimin e partisë që është bërë në shumicën e nëndegëve. Do të thotë, suksesin e bazoj në strukturën dhe mobilizimin e degës dhe në punën që do ta bëjmë. Këtë e bazoj edhe në punën jo të mirë që aktualisht po e bën qeverisja komunale në Pejë, ku çdo ditë qytetarët janë të zhgënjyer.

**"Epoka e re":** Mund të ndikojë në fuqizimin e Aleancës në Pejë rikthimi juaj dhe qeverisja e Aleancës në nivel qendror?

**Berisha:** Qeveria aktuale në nivel qendror është duke bërë punë të rëndësishme për Kosovën. Po kryhen detyrat të cilat kanë pritur vite të tëra për t'u zgjidhur. Qeveria aktuale nuk po i mban në sirtarë çështjet problematike, por po i

zgjidh një nga një. Edhe në të ardhmen besoj se qeveria Haradinaj do t'i realizojë gjërat qenësore siç janë zhvillimi ekonomik, ushtria dhe liberalizimi i vizave. Kjo do të na ndihmojë të jemi ballëhapur nëpër degët ku konkurrojmë për t'i qeverisur komunat. Në Komunën e Pejës do të realizohen shumë projekte zhvillimore, sidomos të aspektit turistik në zonën e Rugovës.

**"Epoka e re":** Z. Berisha, në përgjithësi çfarë vlerësimi keni për qeverisjen në Pejë?

**Berisha:** Qeverisja aktuale në Pejë më tepër merret me reklamimin e punëve të pakryera sesa që ka punuar për përmirësimin e jetës së qytetarëve. Peja ka qenë qyteti më i pastër në Kosovë, kurse sot nuk është i tillë. Peja ka qenë destinacion i turizmit, sot nuk është. Ka shumë ndërtime pa leje, nuk është bërë zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit në fshatra, si dhe një pjesë e qytetit ka problem me ujërat e zeza. Po ashtu, nuk po realizohet projekti turistik 'Borea' me anë të të cilit janë fituar zgjedhjet. Ky projekt është ëndërr e qytetarëve të Pejës, por realizimi i tij ende nuk ka filluar. Qytetarët po e shohin se ky ka qenë vetëm një premtim sa për të ardhur në pushtet. Qeveria ka pasur mbështetje nga niveli qendror, sidomos për disa rrugë nëpër fshatra, të cilat nuk mjaftojnë për ta quajtur të

suksesshme këtë qeverisje. Kështu që, mendoj se në shumicën e aspekteve qeverisja në Pejë ka degraduar, prandaj në mandatin e ardhshëm besoj se qytetarët do ta mbështesin një vizion tjetër dhe një parti tjetër politike për ta udhëhequr komunën.

**"Epoka e re":** Si ishte e mundur që pas keq-qeverisjes në mandatin e parë kryetari aktual t'i fitojë zgjedhjet pa balotazh?

**Berisha:** Ai ka fituar falë mbështetjes së partive politike të caktuara të cilat kanë besuar në realizimin e projektit 'Borea'. Falë këtij premtimi ai ka fituar përkrahjen e një pjese të madhe të qytetarëve dhe me votat e atyre ka fituar pushtetin. Sot e kësaj dite ky projekt nuk ka filluar të realizohet. Edhe partitë që janë pjesë e koalicionit po e shohin se nuk duhet të mbështeten premtimet e porealizueshme. Po ashtu, pavarësisht prej premtimeve të dhëna, gjendja në arsim dhe në shëndetësi nuk është e mirë.

**"Epoka e re":** Si kryetar i Degës së Aleancës në Pejë, çfarë do të bëni për ta përmirësuar këtë qeverisje?

**Berisha:** Do t'i ngrehim ekipet profesionale për përcjelljen e punës së komunës duke i bërë publike të gjitha të gjeturat. Do t'i publikojmë premtimet që janë dhënë, por që ende nuk janë realizuar, sepse qytetarët po mashtrohen me projekte megalomane dhe të pashfrytëzueshme për komunën tonë. Përmes mekanizmit të këshillit profesional dhe përmes këshilltarëve komunalë do të bëjmë një opozitë konstruktive, të fuqishme, duke potencuar nevojat e qytetarëve dhe ofrimin e një alternative serioze për të qeverisur në të ardhmen në Pejë.

## Veseli merr konfirmimin për anëtarësimin e Kosovës në Frankofoni

EPOKA E RE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka pritur të hënën në takim sekretarin e përgjithshëm të Asamblesë Parlamentare të Frankofonisë, Jacques Krabal, me të cilin ka biseduar për anëtarësimin e Kosovës në Asamblesë Parlamentare të Frankofonisë si dhe për zhvillimet aktuale në vendin tonë. Sekretari i AP të Frankofonisë, Krabal, ka theksuar se Kuvendi i Kosovës ka aplikuar për anëtarësim në këtë organizatë dhe dosja është e plotë. Ai ka bërë me dije se vendimi pritet të merret së shpejti dhe Kosova pritet të jetë

anëtare me të drejta të plota. "Në hapësirën tonë frankofone objektiv është gjuha, është kultura, por sfida është edhe ekonomia, së cilës do t'i qasemi bashkë. Sfidat e dytë është demokracia. E përgëzojmë Kosovën për mbrojtjen e Kushtetutës dhe të komuniteteve. Kosova ka bërë punë të mrekullueshme në 10 vjetet e fundit. Kemi bërë punë të mirë në barazinë gjinore dhe duhet ta promovoni këtë edhe në asamble", ka thënë Krabal.

Ndërkaq kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, ka thënë se Asambleja Parlamentare e Frankofonisë është një ndër organizatat më të mëdha ndërkombëtare dhe ka shprehur besimin

se Kosova shumë shpejt, gjatë muajit të ardhshëm, do të jetë anëtare me të drejta të plota. Veseli e konsideroi shumë të rëndësishëm për Kosovën faktin se ajo tashmë po ecën suksesshëm me anëtarësimin nëpër organizata të ndryshme ndërkombëtare. "Ky është lajm i jashtëzakonshëm. E rëndësishme është se ne po marrim përkrahje të vazhdueshme. Franca po e përkrah Kosovën drejt integritetit evropian. E falënderoj sekretarin Krabal për përkrahjen. Me mbështetjen e këtyre njerëzve po arrijmë të anëtarësohemi në organizata ndërkombëtare. Do të jemi bashkë në të gjitha proceset", ka theksuar kryeparlamentari Veseli.





# Në QKUK shpëtohet jeta e pesë pacientëve me vdekje klinike

EPOKA  
ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Pas reanimimit nga ekipi reanimator i Qendrës Emergjente në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), pesë pacientëve që ishin në vdekje klinike u është bërë angiografia-stentimi apo intervenimi kardiokirurgjik. Atyre u është vazhduar disa ditë mjekimi në kuadër të mjekimit intensiv qendror dhe tashmë nga gjendja vdekje klinike gëzojnë shëndet të mirë. "Pesë pacientët janë lëshuar në mjekim ambulator në gjendje të mirë shëndetësore falë bashkëpunimit ekipor ndërmjet shërbimeve të ndryshme në QKUK", është thënë në njoftimin e QKUK-së.

Kjo klinikë ka disa muaj që është në funksion 24 orësh për t'i trajtuar të gjitha rastet e infarkteve akute që kanë nevojë për inter-

venim të menjëhershme.

Operacione të komplikuar vazhdojnë të kryhen edhe tek shërbimi i kardiokirurgjisë, një intervenim i tillë është kryer edhe te pacienti i moshës 56-vjeçare, i cili është diagnostikuar si valvulë bikuspidale (vesë i lindur) dhe me insuficiencë të avancuar të kësaj valvule, zgjerim i aortës ascendente mbi 6 cm, sëmundje të arterieve koronare, sëmundje të sheqerit dhe të veshkave.

Pacientit i është kryer operacioni kompleks në zemër me sukses të plotë.

Operacioni i realizuar kishte si sukses zëvendësimin e valvulës aortale, ndërrimin e aortës ascendente, reimplantimin e arterieve koronare (bentall operation).

Gjithashtu, pacientit i është hequr pllaka aterosklerotike nga arteria koronare dhe realizimi i tre "bypass aorto-koronar".



Operacioni është realizuar nga Adem Grbolar, kirurg kardiokirurg dhe Arbër Kutllavci, kirurg kardiokirurg dhe vaskular. Ekipi është mbështetur nga një staf prej 15 profesionistëve shëndetësorë.

## Kosova ngre lapidar për ushtarët e NATO-s dhe KFOR-it të rënë në shërbim



PRISHTINË, 11 QERSHOR (ER) - Qeveria e Kosovës ka nxjerrë vendimin për ngritjen e lapidarit për ushtarët e NATO-s të rënë në Kosovë, pas hyrjes së trupave të KFOR-it në Kosovë më 12 qershor 1999. Kjo nismë është marrë për ta nderuar sakrificën e ushtarëve të rënë gjatë misionit paqeruajtës në Kosovë, duke vlerësuar kontributin e tyre për ruajtjen e paqes, krijimin e kushteve për një jetë të sigurt për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Ky lapidar i ngritur në Sheshin "Nëna Terezë" të Prishtinës do të përurohet sot (e martë) në orën 11:00. Të pranishëm do të jenë drejtuesit shtetërorë dhe politikë të vendit, përfaqësues nga NATO-ja, ish-komandantë të KFOR-it, familjarë të të rënëve, përfaqësues të shteteve të tyre dhe të ftuar të tjerë.

Lapidari shpreh mirënjohjen për ushtarët e rënë, për familjet e tyre dhe shtetet e tyre në shërbim të paqes dhe të sigurisë. Po ashtu,

për ne është edhe dëshmi e shprehjes së mirënjohjes për ushtarët e aleancës së NATO-s dhe KFOR-it, me çfarë tregojmë jo vetëm nderimin dhe mirënjohjen, por edhe synimin tonë si shtet që edhe Kosova të jetë anëtare e NATO-s. Duke nderuar të kaluarën dhe sakrificën e ushtarëve të NATO-s ne tregojmë edhe përkushtimin tonë drejt së ardhmes. Një komb që nderon sakrificën e aleatëve, ai ka nderuar vetveten dhe të ardhmen e vet.

## Publikohet deklarimi i pasurisë së zyrtarëve të lartë

PRISHTINË, 11 QERSHOR (ER) - Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) ka bërë me dije se ka publikuar të hënën në faqen zyrtare të vet në internet regjistrat e deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë. "Agjencia Kundër Korrupsionit ka publikuar sot në faqen zyrtare të vet në Internet regjistrat e deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, në pajtim me Ligjin për deklarimin, prejardhjen dhe

kontrollin e pasurisë, dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave", është thënë në njoftimin e AKK-së.

AKK-ja ka njoftuar se gjatë bartjes së të dhënave të deklaruara nga formularët e deklarimit të pasurisë tek regjistrat e deklarimeve mund të ndodhin lëshime teknike apo formulime të gabuara. "Andaj kërkohet nga zyrtarët e lartë publikë që ta njoftojnë Agjencinë menjëherë, në mënyrë që të bëhen për-

mirësimet dhe për t'i evituar paqartësitë që mund të krijohen", thuhet në këtë njoftim.

Më tej në njoftim theksohet se pas përfundimit të të gjitha çështjeve teknike të këtij procesi, AKK-ja do ta organizojë aktivitetin publik të hedhjes së shortit për kontrollin e plotë të pasurisë që, sipas ligjit për deklarimin e pasurisë, do t'i nënshtrohen 20 për qind e listës së përgjithshme të zyrtarëve të lartë publikë që kanë deklaruar pasurinë në vitin 2018.



## Nga muaji i ardhshëm një pjesë e stafit të MKRS-së do të kalojë në Prizren

PRISHTINË, 11 QERSHOR (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka folur të hënën lidhur me

premtimin e tij për zhvendosjen e ministrisë që drejton në Prizren. Ai ka thënë se një pjesë e kabinetit të kësaj min-

istrie në muajin e ardhshëm do të zhvendoset. "Jemi afër për të kaluar në Prizren. I kemi vetëm disa çështje

administrative. Besoj se nga muaji i ardhshëm një pjesë e stafit do të kalojë në Prizren", ka thënë ministri Gashi.





# Gjykata Kushtetuese ia lejon Haradinajt rritjen e pagës

EPOKA  
ERE

F. DERMAKU

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Gjykata Kushtetuese ka marrë vendim që rritja e pagave për kabinetin qeveritar nga kryeministri Ramush Haradinaj nuk është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës. Sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, nuk është dëshmuar se vendimi i Qeverisë për rritjen e pagave përbën çështje të nivelit kushtetues. "Me shumicë votash është konstatuar se vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 20/14, i 20 dhjetorit 2017, nuk është në kundërshtim me nenet 3 [Barazia para

Ligjit], 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 7 [Vlerat], 65 [Kompetencat e Kuvendit], 92 [Parimet e Përgjithshme] dhe 93 [Kompetencat e Qeverisë] të Kushtetutës", thuhet në vendimin e publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës Kushtetuese. Në dhjetor të vitit të kaluar, Qeveria e Kosovës, e drejtuar nga Ramush Haradinaj, mori vendim t'ia rrisë pagat gjithë kabinetit qeveritar. Sipas këtij vendimi, paga e kryeministrit nga 1 500 euro sa ka qenë, do të bëhet 2 950 euro, kurse e zëvendëskryeministrave nga 1 300 euro, në 2 500 euro.

Paga e një ministri ka qenë rreth 1



200 euro ndërkaq, sipas këtij vendimi, do të jetë 2 000 euro. Kurse mbi 70 zëvendësministra, të emëruar në Qeverinë Haradinaj, do të marrin pagë mujore nga 1 150 euro. Deputetë të Lëvizjes Vetëvendosje kishin dorëzuar ankesë në Gjykatën Kushtetuese, duke kërkuar shpalljen e këtij vendimi si kundërkushtetues. Mirëpo, Gjykata Kushtetuese konstatoi se vendimi i Qeverisë nuk është kundërkushtetues. Kryeministri Haradinaj e kishte pezulluar vendimin që i dyfishonte rrogën e tij për ta pritur vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

## KMDLNj-ja kërkon hetim për rastin e 53 milionëve për 'Bechtel Enka'-n



PRISHTINË, 11 QERSHOR (ER) - "Shkatërruesi i mjedisit në Kosovë dhe aspiratori i buxhetit të Kosovës me kontrata krejtësisht të mjegulluara, 'Bechtel Enka', arriti t'i thithë buxhetit social të Kosovës edhe 53 milionë euro të buta, duke ndikuar edhe më shumë në përkeqësimin e

gjendjes ekonomike - sociale të pjesës dërrmuese të qytetarëve të Kosovës", kështu është thënë në një komunikatë të Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut (KMDLNJ).

KMDLNj-ja ka bërë thirrje për hetime të shpejta, të pavarura dhe të

pandikuara politikisht për rastin e 53 milionëve që iu paguan 'Bechtel Enka'-s. "Në kohën kur ish-ministri Lutfi Zharku deklaroi publikisht se detyrimi ndaj kësaj kompanie nuk ka qenë më shumë se 14.6 milionë euro. Për rastin konkret duhet të caktohet

përgjegjësia, ose për ish-ministrin Zharku për deklarin të së pavërtetës, ose për ministrin Lekaj për 'qerasje' të jashtëzakonshme bujare për këtë kompani. Në këtë rast nuk mund të jenë dy të vërteta", është thënë në komunikatën e KMDLNj-së.

## Nismës Socialdemokrate i bashkohen dhjetëra anëtare të reja



PRISHTINË, 11 QERSHOR (ER) - Partisë së Fatmir Limajt i janë bashkuar të hënën dhjetëra anëtare të reja. Kryetarja e Gruas së Nismës Socialdemokrate, Valdete Bajrami, i ka falënderuar anëtarët e reja që kanë zgjedhur Nismën për ta dhënë kontributin e tyre. Ajo u ka premtuar atyre se do ta kenë gjithë hapësirën e nevojshme për ta dhënë kontributin e tyre. "Ne si Nismë e Gruas funksionojmë që nga

themelimi i Nismës. Fryma të cilën e kultivojmë është liri, drejtësi dhe solidaritet. Organi i Nismës së Gruas është i konsoliduar në secilën degë. Një angazhim i përbashkët nuk do t'i mungojë Nismës në përgjithësi", ka thënë Valdete Bajrami.

Më tutje, ajo ka folur për politikën e Nismës. Kjo parti, sipas saj, nuk jep premtime, por zotime. Katër zotimet e Nismës, sipas saj, janë pjesë e programit qeveritar dhe

po zbatohen nga dikasteret përkatëse. Nisma, sipas saj, është dëshmuar si parti konsistente që prej themelimit të saj. Bajrami ka thënë se Nisma është parti që ia ofron mundësinë gruas në vendimmarrje. Fuqizimi i Gruas së Nismës, sipas saj, nënkupton edhe fuqizimin e partisë.

Ndërkaq ministri i Arsimit, Shyqiri Bytyqi, iu ka dëshiruar mirëseardhje anëtareve të reja. Ai ka thënë se kanë marrë vendim të mirë që i

janë bashkuar Nismës. Bytyqi ka thënë se qytetarët e Kosovës kanë nevojë për politikën socialdemokrate të Nismës. "Nisma në çdo degë të Kosovës po zgjerohet dhe po rritet. Neve na presin shumë punë. Pretendimet e Nismës janë shumë më të mëdha. Të gjithë anëtarët e ri do ta kenë hapësirën e nevojshme për ta dhënë kontributin e tyre", ka thënë Bytyqi. E, anëtarët e reja të Nismës kanë thënë se kanë zgjed-

hur këtë subjekt pasi është dëshmuar si parti që po angazhohet për mirëqenien e qytetarëve. Ato thanë se do të mundohen t'i zgjidhin problemet e grave gjithandëj vendit. Programi politik dhe platforma thanë se ishin ndër arsytet që i kanë bindur t'i bashkohen Nismës. Po ashtu, edhe mbështetjen dhe hapësirën që po ua jep Nisma të rinjve dhe grave, thanë se është një tjetër arsye që i janë bashkuar këtij subjekti.



## Bizneset austriake të interesuara për të investuar në Kosovë

PRISHTINË, 11 QERSHOR (ER) - Ministri i Financave, Bedri Hamza, gjatë vizitës zyrtare në Austri, përveç takimit bilateral me ministrin e Financave të Qeverisë së Austrisë, mori pjesë edhe në forumin e bizneseve austriake për t'i njoftuar me mundësitë e investimit në Kosovë. Me këtë rast, ministri Hamza i ka informuar bizneset austriake për politikat e favorshme që ka Kosova për investime. Po ashtu, ministri Hamza i ka informuar bizneset austriake se në këtë nëntëmujor të mandatit ka marrë vendim për lirim nga tatimi doganor të lëndës së parë, të gjysmëprodukteve, të linjave të prodhimit dhe të

pajisjeve të TI-së. "Po ashtu, kemi liruar nga tatimi i akcizës të gjitha lëndët ndihmesë që marrin pjesë në procesin e prodhimit", ka thënë Hamza, duke treguar për mundësitë e tjera që ofron Kosova. "Kosova ka një sistem shumë të avancuar financiar. Ka një fuqi punëtore që është shumë e re në moshë dhe që flet më shumë se dy gjuhë të huaja", ka thënë ai. Në fund të forumit, ministri Hamza, në bazë të kërkesës së madhe të bizneseve austriake, pati takime bilaterale me një numër të madh të bizneseve që ishin të interesuar për të marrë informata më konkrete për të investuar në Kosovë.



## MMPH-ja dhe Ambasada Suedeze thellojnë bashkëpunimin në fushën e mjedisit

PRISHTINË, 11 QERSHOR (ER) - Ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, ka pritur të hënën në takim ambasadorin suedez në Kosovë, Henrik Nilsson, i cili ishte i shoqëruar nga stafi i ambasadës që përcjellin projektet e financuara nga Suedia. Ministrja Reshitaj, pasi ka prezantuar prioritetet dhe veprimet e saj në përmirësimin e gjendjes së mjedisit në Kosovë, ka falënderuar shtetin suedez për përkrahjen e vazhdueshme që po i jep Kosovës, në veçanti në fushën e mjedisit. Ajo ka vlerësuar se Suedia është një shembull shumë i mirë për t'u ndjekur sa i përket çështjes së mjedisit dhe zgjidhjes së problemeve mjedisore. Po



ashtu, ministrja shfaqti shqetësimin e saj meqë nuk ka informata për burimet ujore që

ka Kosova që nga viti 1984. Reshitaj ka shprehur interesim të fillojë me hulumtime për ta

vrojtuar situatën aktuale të kapaciteteve ujore që ka Kosova.

Ndërsa ambasadori Nilsson ka theksuar bashkëpunimin e mirë afatgjatë që ekziston mes Suedisë dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Ambasadori Nilsson ka përmendur mbrojtjen e mjedisit si një fushë shumë të rëndësishme për integrimet Evropiane të Kosovës. Ai ka thënë se për qeverinë suedeze mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimet klimatike janë prioriteti i lartë.

Suedia është duke punuar në procesin e një bashkëpunimi të ri katërvjeçar të mbështetjes institucionale mes Agjencisë Suedeze për Mbrojtje të Mjedisit dhe Agjencisë për Mbrojtje të Mjedisit të Kosovës, që është planifikuar të fillojë vitin tjetër.

## Bie kostoja e ndërtimit në Kosovë

PRISHTINË, 12 QERSHOR (ER) - Kostoja e ndërtimit në Kosovë ka shënuar rënie -0.7 për qind në tremujorin e parë të këtij viti krahasuar me tremujorin e katërt të vitit të kaluar. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) për tremujorin e parë të vitit 2018, rënia më e madhe u shënuar në sektorin energji -4.9 për qind dhe materiale -1 për qind, derisa ngritje e lehtë u vërejt te makineritë me 0.7 për qind dhe kostot e tjera 0.5 për qind. Sipas ASK-së, krahasuar tremujorin e parë 2018 me të njëjtën periudhë kohore të vitit të kaluar, indeksi i kostonë ndërtimit kishte ngritje me një mesatare prej 0.6 përqindësh, ku ngritja e indeksit u vërejt kryesisht te kategoria e materialeve prej 1 përqindësh. Ndërsa kategoritë që kishin rënie ishin makineria me -2.2 për qind dhe energjia -1.4 për qind.





# Tahiri: Do të konfiskohen pasuritë e fituara jashtëligjshëm

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka paralajmëruar masa rigoroze të sistemit të drejtësisë për konfiskimin e të gjithë pasurive në vlerë prej 10 mijë eurosh të zyrtarëve shtetërorë të fituar në mënyrë të kundërligjshme. Në një konferencë për media mbajtur të hënën ai ka bërë me dije sot (e martë) do të hyjë në agjendën e Qeverisë Projektligji i ri për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë



**EPOKA ERE** Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË, 12 QERSHOR** - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, në një konferencë për media mbajtur të hënën, ka prezantuar ndryshimet kryesore në Projektligjin e ri për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë. Tahiri ka bërë me dije se ky projektligj do të hyjë sot (e martë) në agjendën e Qeverisë. Me këtë rast, ai ka ftuar deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës të miratojnë sa më parë këtë projektligj, në mënyrë që të vendoset baza e nevojshme ligjore për t'u mbrojtur interesi publik dhe i qytetarëve të Republikës së Kosovës. "Jam i bindur se me këtë projektligj, po bëjmë hapin më vendimtar ndaj keqpërdoruesve, ndaj personave që merren me krim të organizuar, ndaj personave zyrtarë e politikë që mund të kenë llogaritur se do të mund të pasurohen përmes korrupsionit dhe abuzimit me pushtetin", ka thënë ministri Tahiri.

Ministri Tahiri ka bërë me dije se konfiskimi mund të bëhet për çdo pasuri të përfituar me vepër penale në dhjetë vjetët e fundit nga momenti i nisjes së

hetimit për një vepër penale të listuar në ligj, ndërkaj vetë i pandehuri duhet të dëshmojë mënyrën se si e ka përfituar këtë pasuri, dhe jo prokurori. Sipas tij, konfiskimi është zgjeruar jo vetëm për të pandehurin, por edhe për palët e treta nëse nuk janë blerës bona fide i asaj pasurie, masë kjo për ta pamundësuar transformimin e pasurisë së të pandehurit tek palët e tjera me qëllim të fshehtë apo përdorimit për interes të të pandehurit. Tahiri ka thënë se ky projektligj mbetet më i rëndësishmi në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Ai ka thënë se çfarëdo pasurie e cila është fituar me vepër penale dhe kap shifrën 10 mijë euro do të konfiskohet. "Ky projektligj është ndër më të rëndësishmit në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Ky projektligj përçon një mesazh të rëndësishëm për të gjithë ata që me vite janë pasuruar me vepra penale. Jam i bindur se me këtë projektligj po e bëjmë hapin përfundimtar ndaj atyre që janë pasuruar me vepra penale. Çdo gjë do të konfiskohet përderisa nuk është fituar në mënyrë të ligjshme. Pra, çdo pasuri që kap vlerën 10

mijë euro do të konfiskohet. Për vitin 2018 është rritur stafi dhe do të jenë 300 punëtorë të rinj. Jemi në proces të rekrutimit edhe të 39 gjyqtarëve të rinj gjatë këtij viti", ka thënë ai.

Tahiri ka theksuar se me anë të miratimit të këtij ligji do të jenë konform direktivave të BE-së dhe, sipas tij, me anë të këtij ligji do të luftohen krimi dhe korrupsioni. Ai ka bërë me dije se rekomandimi i Komisionit Evropian për liberalizimin e vizave do të jetë pozitiv pasi, siç ka thënë ai, Kosova ka arritur ta plotësojë kushtin për sekuestrimin e pasurisë. "Besoj se komisioni është i kënaqur me vlerësimin e raportit. Ne si Qeveri, si institucione, kemi arritur ta plotësojmë këtë kusht tejet të rëndësishëm. Pres që rekomandimin ta kemi

pozitiv sepse është bërë punë shumë e madhe në gjashtë muajt e fundit", është shprehur Tahiri.


Ministri Tahiri ka theksuar se veprat penale për të cilat vlen konfiskimi i pasurisë janë shtuar dukshëm, nisur nga veprat penale të krimit të organizuar, korrupsionit dhe veprat penale të ndërlidhura me detyrën zyrtare, kundër shëndetit publik, të trafikimit të qenieve njerëzore, ato që lidhen me konfliktet e armatosura jashtë territorit të vendit, të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe veprat penale që ndërlidhen me substancat narkotike dhe armët dhe veprat penale kibernetike, ato kundër ekonomisë, kundër pronës dhe kundër ambientit. "Ky projektligj është

ndër më të rëndësishmit në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe, si i tillë, Republikën e Kosovës e klasifikon si një prej shteteve me sistemin më të avancuar në rajon dhe brenda vetë Bashkimit Evropian sa iu përket procedurave dhe modelit të konfiskimit të pasurisë së përfituar me vepër penale. Ky projektligj është shprehje e vullnetit tim politik si ministër i Drejtësisë, për luftë të pakompromis kundër këtyre dukurive dhe, si i tillë, tregon përkushtimin e Republikës së Kosovës për të çuar një mesazh të fuqishëm ndaj të gjithë atyre që për vite në mënyrë të paligjshme kanë përfituar pasuri nga veprat penale, se një gjë e tillë tashmë nuk do të jetë e mundur", ka thënë Tahiri.

## Dogana pranon donacion nga Dogana e Mbretërisë së Bashkuar

**PRISHTINË, 11 QERSHOR (ER)** - Në sajë të bashkëpunimit dhe përpjekjeve të përbashkëta në luftimin e krimit të organizuar dhe kontrabandës, drejtori i përgjithshëm i Doganës së Kosovës, Bahri Berisha, ka prituri në vizitë përfaqësuesit e Doganës së Britanisë së Madhe, Andrew Pavlinic, shef për Inteligjencën Ndërkombëtare dhe Andy Lawson, drejtues në të njëjtin seksion.

Në këtë takim u prezantua një donacion i pajisjeve për forenzikë digjitale, i dhënë Doganës së Kosovës, me qëllim të përmirësimit të kapaciteteve që ndihmojnë në luftimin e krimit të organizuar dhe kontrabandës. Këto pajisje janë mod-



erne dhe versioni më i fundit i pajisjeve të këtij lloji, andaj në kohën e teknologjisë së avancuar këto pajisje do të jenë ndihmesë e madhe për Doganën e Kosovës për sigurimin e provave dhe të informatave të besueshme për proceset hetimore dhe gjyqësore. "Dogana e Mbretërisë së Bashkuar gjithmonë ka qëndruar afër doganës sonë, prandaj edhe jemi thellësisht falënderues për asistencën që nga themelimi i doganës e deri tani. Gjithmonë kemi pasur një mbështetje nga Dogana e Mbretërisë së Bashkuar", ka thënë drejtori i përgjithshëm i Doganës së Kosovës, Bahri Berisha.



## Komuna e Prishtinës shënon Ditën e Çlirimit

PRISHTINË, 11 QERSHOR (ER) - Kuvendi Komunal i Prishtinës ka mbajtur të hënën një seancë solemne për ta shënuar 19-vjetorin e çlirimit të kryeqytetit. Të pranishëm në këtë seancë kanë qenë drejtuesit e Organizatës së Familjeve të Dëshmorëve, asaj të Veteranëve të Luftës të UÇK-së, si dhe të Organizatës së Invalidëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Agim Kuleta, nënkryetari i Komunës së Prishtinës, Selim Pacolli, si dhe kryetari i OVL-UÇK-së në Prishtinë, Fatmir

Sopi, kanë mbajtur një fjalë rasti në këtë seancë solemne, me ç'rast kanë ritheksuar rëndësinë e luftës çlirimtare që ka ndodhur në Kosovë, luftë kjo që ishte kulmi i angazhimit politik të shumë gjeneratave për shumë dekada.

Pas seancës solemne delegacioni i përbërë nga përfaqësues të ekzekutivit, Kuvendit Komunal si dhe organizatave të dala nga lufta e UÇK-së kanë bërë homazhe te varrezat e dëshmorëve në Prishtinë si dhe te shtatorja e heroit të kombit, Zahir Pajazitit.



## Në Ferizaj mbahet marshi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

FERIZAJ, 11 QERSHOR (ER) - Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Ferizajt, Kristina Gashi-Bytyçi, nënkryetari i kësaj komune, Naim Ferati, dhe drejtorë të drejtorive komunale, kanë marrë pjesë të hënën në marshin për të drejtat e fëmijëve dhe kundër punës së detyruar të fëmijëve, që është organizuar nga "Caritas Kosova", "Terre Des Hommes"

- misioni në Kosovë, si dhe shoqata e grupe të tjera sociale. Duke theksuar angazhimin e qeverisjes lokale në drejtim të avancimit të të drejtave të fëmijëve, Gashi-Bytyçi ka theksuar se institucioni i Kuvendit dhe kryetari i Ferizajt, Agim Aliu, e kanë në agjendë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. "Platforma politike e kryetarit

të komunës, Agim Aliu, ka kapitull të veçantë mbrojtjen e familjes, gjegjësisht mbrojtjen e të drejtave të të rinjve dhe fëmijëve", ka thënë Gashi-Bytyçi. Ky aktivitet është organizuar në kuadër të muajit të diversitetit kulturor, përkatësisht Ditës Botërore për të Drejtat e Fëmijëve dhe Ditës Ndërkombëtare Kundër Punës së Detyruar nga Fëmijët.



## Binjakëzohen Prizreni dhe Berati

PRIZREN, 11 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, dhe ai i Bashkisë së Beratit, Petrit Sinaj, kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, e cila parasheh binjakëzimin e dy komunave. Me këtë rast, Haskuka ka thënë se kjo marrëveshje do të kontribuojë për

forcimin e raporteve në mes të Prizrenit dhe Beratit. "Tani e tutje me qytetin e Beratit do t'i shkëmbejmë përvojat në fusha të ndryshme, me qëllim të përfitimit të të dy palëve. Siç dihet, Berati është qytet i njohur në UNESCO dhe me këtë rast edhe ne do t'i përcjellim hapat e Beratit për t'u njohur nga kjo

organizatë, duke besuar gjithmonë në vlerat e trashëgimisë kulturore që ka qyteti i Prizrenit", ka thënë Haskuka, duke shtuar se marrëveshja e nënshkruar do të kontribuojë në forcimin e marrëdhënieve në fushën e kulturës, ekonomisë, sportit, turizmit, trashëgimisë dhe arsimit.

## Nis projekti në Skenderaj për rritjen e kapacitetit të ujit

SKENDERAJ, 11 QERSHOR (ER) - Kanë filluar punimet rreth ndërtimit të rezervuarit të ujit tek Hidro-Stacioni i Pompave të Ujit në Shipol. Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka bërë me dije se ky projekt madhor do të

shërbejë për t'i furnizuar rezervarët e ndërtuara në fshatrat e kësaj komune me një kapacitet të prurjes së ujit mbi 300 litra në sekondë. Projekti mbështetet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.



## Nga 15 korriku në Mitrovicë mbahet Panairi i Prodhimeve Vendore



MITROVICË, 11 QERSHOR (ER) - Nën udhëheqjen e kryetarit të komunës Agim Bahtiri dhe në prani të nënkryetarit Faruk Mujka është mbajtur të hënën mbledhja e radhës e Bordit të Drejtorëve, në të cilën u shqyrtuan pikat e rendit të ditës të propozuara nga drejtorët e drejtorive komunale.

Si pikë më e rëndësishme e rendit të ditës ishte fillimi i përgatitjeve për regjistrimin e nxënësve në shkolla të mesme të larta, për të cilat u tha se kanë filluar dhe se çdo gjë është gati që procesi i regjistrimit të përfundojë ashtu si duhet. Edhe pika

tjetër e rendit të ditës kishte të bëjë me arsimin, përkatësisht lirin e hapësirave shkollore nga shfrytëzuesit e ndryshëm. Me këtë rast u përmenden tri raste që hapësirat duhen liruar nga shfrytëzuesit joligjorë për shkak se ato u nevojiten institucioneve arsimore.

Pikë tjetër e rendit të ditës për të cilën anëtarët e Bordit të Drejtorëve diskutuan dhe u pajtuan ishte organizimi i panairit të prodhimeve vendore, me ç'rast u theksua rëndësia e mbajtjes së tij, për çka edhe u vendos që ai të mbahet dy herë në javë, nga data 15 korrik deri më 15 gusht.



# HISTORIA E BISEDIMEVE POLITIKE NË MES TË PRISHTINËS DHE BEOGRADIT

(Përkujtues për vendorë e ndërkombëtarë, për raportet shqiptare e serbe në bisedimet për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi)



Shkruan: Jakup KRASNIQI

## Hyrje

Qytetarët e Kosovës si dhe partitë politike edhe para Rambujesë e pas saj kanë qenë shumë të interesuar të gjejnë zgjidhje politike me Serbinë. Që nga bisedimet e Vjenës e sidomos pas Pavarësisë kanë qenë e janë të interesuar për t'i normalizuar marrëdhëniet ndërshtetërore me Serbinë. Por, pas pesë e më shumë vjetësh të bisedimeve të Brukselit jemi të bindur dhe besojmë fort në bindjet tona, se mënyra se si kanë filluar bisedimet politike me ndërmjetësimin e Brukselit dhe sidomos se si janë udhëhequr e zhvilluar ato, vështirë se do të kemi normalizim të marrëdhënieve Kosovë - Serbi. Dhe për këtë faji nuk është në Prishtinë, por te politikë e vjetra të kriminit e të gjenocidit të ushtruar nga Beogradi zyrtar dhe jo vetëm në luftën e fundit.

## Historia e bisedimeve politike Serbi - Kosovë

Kosova me ndërmjetësimin e faktorit ndërkombëtar e sidomos të vendeve anëtare të Grupit të Kontaktit ka zhvilluar bisedime dy herë. Dhe Serbia asnjëherë, deri më sot, nuk i ka pranuar rezultatet finale të bisedimeve, ashtu si nuk po i pranon as këto të zhvilluara nën mbikëqyrjen e Brukselit zyrtar, të cilat ishin të autorizuar me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, që të ishin bisedime teknike. Edhe në bisedimet e Brukselit të filluara si teknike e që përfunduan në bisedime politike, pala e Kosovës veç sa i ka thelluar kompromiset, duke hequr dorë nga të qenit palë e

barabartë në bisedime. Dëshmi për këtë është fusnota (që e mohon pavarësinë) dhe të gjitha çështjet e brendshme të Kosovës që u biseduan atje. Me këtë veprim pala e Kosovës në bisedime ka shkelur vullnetin e qytetarëve të Kosovës të shprehur përmes përfaqësuesve të tij të zgjedhur në Kuvendin e Kosovës më 17 shkurt 2008.

I. Në bisedimet e para që janë zhvilluar në Konferencën Ndërkombëtare për Kosovën në Rambuje të Francës (shkurt - mars 1999) pala shqiptare pat bërë një kompromis goxha të madh. Arsyeja ishte se pala shqiptare donte të sakrifikoje për zgjedhjen politike e paqësore të luftës se filluar në shkurtin e vitit 1998 (e pranuar ndërkombëtarisht, se ajo kishte filluar vite më parë). Serbia edhe pas dy raundeve të bisedimeve të zhvilluara në Rambuje (shkurt '99) e Paris (mars '99) nuk e pat nënshkruar Dokumentin Përfundimtar të Marrëveshjes. Mosgatishmëria e regjimit të Millosheviqit për ta nënshkruar Dokumentin përfundimtar të Marrëveshjes, Bashkësia Ndërkombëtare u obligua të kërkonte rrugë tjetër. Zgjedhja tjetër ishin bombardimet e NATO-s në territorin e Federatës së mbeur jugosllave (Serbi - Mal i Zi). Deri te një zgjedhje erdhi vetëm pas bombardimeve 78-ditëshe të NATO-s, të cilat nuk do të ndodhnin pa ndikimin e fuqishëm të ShBA-së, MB e më vonë edhe të vendeve të tjera anëtare të NATO-s. Pastaj vjen Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit, në të cilën thuhet: Kosova është protektorat i OKB-së. Sipas kësaj rezolute, OKB-ja ka përgjegjësinë për administratën civile, kurse NATO-ja për sigurinë në Kosovë. ([https://sq.wikipedia.org/wiki/Procesi\\_i\\_Pavar%C3%ABsis%C3%AB\\_s%C3%AB\\_Kosov%C3%ABs](https://sq.wikipedia.org/wiki/Procesi_i_Pavar%C3%ABsis%C3%AB_s%C3%AB_Kosov%C3%ABs))

II. Herën e dytë bisedimet dyvjeçare (2006 - 2007) të zhvilluara në Vjenë.

Bisedimet e Vjenës u zhvilluan nën udhëheqjen e emisarit special të sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, nga presidenti i Finlandës Marti Ahtisari, me mbikëqyrjen e shteteve që e përbënin Grupin e Kontaktit (GK). Pas bisedimeve të gjata dhe njerëzve specialë të angazhuar në pjesën e dytë të bisedimeve (2007), një nga ShBA-ja ambasadori (Frank Wisner), një nga BE-ja dhe ai ishte ambasadori gjerman (Wolfgang Ishcinger) dhe i treti nga Rusia, i dërguari i posaçëm i Ministrisë së Jashtme Ruse (Aleksander Bozan - Kharchenko). Rusia ishte anëtare e GK dhe pjesëtare e bisedimeve të Vjenës që nga deklarata e parë e GK e cila edhe e hapi fillimin e bisedimeve. Deklarata nënvizonte se nuk ka kthim para vitit 1999 dhe nuk ka bashkim me ndonjë vend tjetër. Pra, orientimi ishte kah pavarësia. Edhe vazhdimi nga treshja e përmendur, palët i nuk ndryshuan qëndrimet e tyre. Dokumenti Përfundimtar për Zgjedhjen e Statusit Përfundimtar për Kosovën, i cili ishte rezultat i atyre bisedimeve, nuk ishte vullneti i shqiptarëve të Kosovës, natyrisht nuk ishte as vullneti i Serbisë. Dokumenti ishte i palës që i udhëhoqi bisedimet (komuniteti ndërkombëtar), pra ishte kompromis i ofruar nga shtetet anëtare të GK. Pa dyshim për shqiptarët ishte kompromis tepër i madh, por ama ishte kompromis për Pavarësinë e Mbikëqyrur të Kosovës dhe kjo ishte arsyeja që e pat pranuar pala e Kosovës. Komuniteteve pakicë, veçanërisht pakicës serbe, iu dhanë shumë të drejta e fare pak obligime, mbase asfale. Ndonëse ai nuk përbën më shumë se 5 % në numrin e përgjithshëm të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Më 15 mars 2007 dokumenti i qe dorëzuar OKB-së nga zëvendësi i M. Ahtisarit, zoti Rohan. (B92 - Info - Report: Plan explicitly recommends independence) Më 26 mars 2007 Martti Ahtisaari i dërgon raportin përfundimtar Këshillit të Sigurimit të OKB-së, ku ai thotë se Kosova duhet të bëhet e

pavarur (BBCAlbanian.com News).

Në Dokumentin Gjithëpërfshirës për Zgjedhjen e Statusit Përfundimtar të Kosovës ishte paraparë që Pavarësia e mbikëqyrur do të arrihej në KS, i cili do ta shfuqizonte Rezolutën 1244 dhe me një Rezolutë ta njilte Pavarësinë e Kosovës, e cila automatikisht do të bëhej anëtare e OKB-së. Por, ky variant nuk shkoj, pastaj u zgjodh rrua tjetër që në koordinim me faktorin ndërkombëtar, Pavarësia të shpallej në Kuvendin e Kosovës dhe kjo u bë më 17 shkurt 2008. Vlen të theksohet se para se të shpallej në Kuvendin e Kosovës, ajo që pranuar më 29 mars 2007 nga Parlamenti Evropian i cili miraton një rezolutë ku shprehet përkrahja për pavarësi të mbikëqyrur për Kosovën. Me 490 vota për, 80 kundër dhe me 87 abstenime. Ndërsa më 10 qershor 2007, presidenti amerikan George W. Bush viziton Tiranën, në atë rast ai thotë se Kosova do ta marrë pavarësinë. Po për këtë çështje kryeministri i MB Toni Blair, para se ta lëshojë zyrën e kryeministrit, thotë: "Jam krenar për rolin që Britania e Madhe ka luajtur për t'i dhënë popullit të Kosovës një të ardhme më të mirë" ([https://sq.wikipedia.org/wiki/Procesi\\_i\\_Pavar%C3%ABsis%C3%AB\\_s%C3%AB\\_Kosov%C3%ABs](https://sq.wikipedia.org/wiki/Procesi_i_Pavar%C3%ABsis%C3%AB_s%C3%AB_Kosov%C3%ABs)). Më pastaj, Serbia e dërgoi në GjND ankesën e saj për shpalljen e pavarësisë dhe në korrik të vitit 2010, mori përgjigjen se Pavarësia e Kosovës nuk bie ndesh me ligjin ndërkombëtar. "Gjykata, rrjedhimisht, ka gjetur se Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit nuk i ndalon autorët e Deklaratës së Pavarësisë së 17 shkurtit 2008, nga shpallja e deklaratës së pavarësisë nga Republika e Serbisë. Prandaj, Deklarata e Pavarësisë nuk paraqet shkelje të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit", tha presidenti i gjykatës, Hisashi Owada. Pra, "Gjykata konsideron se e drejta ndërkombëtare e përgjithshme nuk përmban ndalesë të zbatueshme për deklarata të pavarë-

sisë. Rrjedhimisht, ajo konkludon se Deklarata e Pavarësisë e 17 shkurtit të vitit 2008 nuk e shkel të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare".

## III.

Herën e tretë, bisedimet e Brukselit filluan si bisedime teknike, pa asnjë arsyeje e konsensusi nacional këto bisedime u shndërruan në bisedime politike. Këto bisedime jo vetëm se nuk kanë zgjidhur gjë, veçse shtetin e Kosovës dhe institucionet e tij i kanë bërë jofunksionale. Marrëdhëniet me Serbinë jo vetëm se nuk janë normalizuar, por disa herë vetëm sa janë acaruar. Kujtoni trenin nacionalist serb. Këto bisedime e prodhuan Listën Serbe në institucionet e Kosovës e cila nuk i mbron interesat e qytetarëve serbë të Kosovës. Ata në institucionet e Kosovës mbrojnë interesat e politikës agresive të Beogradit e cila ka qëllim të prodhojë sa më shumë destabilitet e pasiguri.

Në një situatë të tillë palës sonë (politikës shqiptare) s'i mbetet gjë tjetër veçse të kërkojë konsensus nacional për t'i sjellë bisedimet në binarë normalë brenda vetvetes. Vazhdimi i bisedimeve nuk duhet të ndodhë pa u krijuar konsensusi nacional, si dhe ndryshuar si në formë, po ashtu edhe në përmbajtje, substanca e bisedimeve. Për të vazhduar këto bisedime duhet një platformë e re dhe ekip i ri negociator. Ata apo ai që i ka sjellë këto bisedime në këtë gjendje nuk duhet të lejohen në asnjë mënyrë të jenë pjesë e këtyre bisedimeve ose, më së shumti, të jetë pjesë ceremoniale e atyre bisedimeve. Nuk ka asnjë dyshim, as pala e Kosovës e as ajo e komunitetit ndërkombëtar nuk e kanë gjetur gjuhën që do ta kuptonte politika zyrtare e Beogradit e cila nuk po mund të gjejë forcë që të shpëputet nga shtrati i politikave agresive e gjenocidare të Millosheviqit. Politikë që nuk i qëndron me korrektësi asnjë marrëveshjeje. Gjithë historia e bisedimeve me Serbinë e tregon këtë.

## Universitetet do t'i shpallin konkurset pranuese për studentë në të njëjtën ditë

MITROVICË, 11 QERSHOR (ER) - Universitetet publike do t'i shpallin konkurset për pranimin e studentëve për vitin akademik 2018/19 në të njëjtën ditë. Për këtë u pajtuan rektorët e këtyre universiteteve në takimin e radhës së Konferencës së Rektorëve që u mbajt të hënën në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë. Rektorët thanë se kanë bërë të gjitha përgatitjet e duhura për hapjen e konkurseve për pran-

imin e studentëve në vitin akademik 2018/19. Konkurset do të hapen pasi Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë t'i miratojë propozimet për numrin e studentëve që do të pranohen në secilin universitet. Në këtë mbledhje rektori i Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, prof. dr. Ramë Vata, u zgjodh kryesues i ri i Konferencës së Rektorëve, i cili do të pasojë në këtë post rektorin e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina",

prof. dr. Marjan Dema. Zëvendëskryesues u zgjodh rektori i Universitetit "Haxhin Zeka" në Pejë, prof. dr. Fadil Millaku. Rektorët e kanë falënderuar kryesuesin e deritashëm të Konferencës së Rektorëve, prof. dr. Marjan Dema, për angazhimin dhe punën e bërë. Një vit pas themelimit të kësaj konference u vlerësua se është bërë një punë jashtëzakonisht e mirë që duhet të vazhdojë edhe në të ardhmen.





## Tsipras dhe Zaev bisedojnë për emrin e Maqedonisë

**SHKUPI, 11 QERSHOR** - Dy kryeministrit, ai i Greqisë dhe i Maqedonisë, kanë zhvilluar të hënën një bisedë telefonike, ku në qendër të argumentit ka qenë emri i ri i Maqedonisë.

Telefonata e shumëpërfolur Tsipras-Zaev, lidhur me përpjekjet

për zgjidhjen e çështjes së emrit, është realizuar të hënën pasdite. Por bashkëbisedimi i dy kryeministrave nuk ka prodhuar ndonjë lajm. Zyra e shtypit e kryeministrit të Greqisë tha se ishte Zaevi ai që telefonoi Tsipras. "Komunikimi u zhvillua në klimë të mirë, zgjati një

orë dhe nesër do të ketë një telefonatë të re për t'i finalizuar bisedimet", thuhet në njoftimin e zyrës së shtypit të kryeministrit Tsipras.

Më herët, paraditen e së hënës, Tsipras ishte takuar për më shumë se një orë me ministrin e Jashtëm,

Nikos Kotzias. Edhe pse objekt i këtij takimi ishin Athina dhe Shkupi, Kotzias nuk bëri asnjë deklaratë kur doli nga selia e kryeministrit. Maqedonia Veriore dhe Maqedonia e Re janë dy ndër emrat më të mundshëm për vendin fqinj.



## Çfarë pritet nga takimi Trump - Kim Jong?

ShBA-ja shprehet e kënaqur me ecurinë e bisedimeve dypalëshe me Korenë e Veriut, kurse kjo e fundit ka dhënë sinjale se kërkon ta ndryshojë historikun e marrëdhënieve me Uashingtonin, duke kërkuar hapjen e një kapitulli të ri. Por në ShBA dhe tek aleatët në Seul dhe Tokio ka dyshime



**UASHINGTON, 11 QERSHOR** - Shtetet e Bashkuara të Amerikës shprehen të kënaqura me ecurinë e bisedimeve dypalëshe me Korenë e Veriut.

Shtëpia e Bardhë konfirmoi për mediet se në disa çështje përparimi është i dukshëm dhe më i shpejtë nga sa e priste administrata e Donald Trumpit, e për më tepër atmosfera pozitive do të vulozet me një takim kokë me kokë në mes të presidentit amerikan dhe Kim Jongut.

Koreja e Veriut ka dhënë sinjale se kërkon ta ndryshojë historikun e marrëdhënieve me Uashingtonin, duke kërkuar hapjen e një kapitulli të ri. Por, në ShBA dhe tek aleatët në Seul dhe Tokio ka dyshime.

Koreano-jugorët dhe japonezët mirëpresin afrimin, uljen e ten-

sioneve dhe bisedimet në tryezë, por kërkojnë të bëhet kujdes se mos bëhet fjalë për një lojë të Kim Jongut. Historia u jep të drejtë pesimistëve, pasi në disa raste Peniani ka zbutur tensionet me ShBA dhe Seul, por për vetëm për pak kohë dhe është rikthyer sërish në llogoret e propagandës dhe provokimeve.

Ministri i Jashtëm i vendit pritës, Vivian Balakrishnan, takoi veç e veç presidentin Trump dhe më pas edhe Kim Jongun të dielën. "Që të dy udhëheqësit duket plot vetëbesim dhe të gatshëm për të biseduar për gjithçka e pa komplekse me njëri-tjetrin", deklaroi kryediplomati i Singaporit.

Balakrishnan zbuloi edhe se Singapori do ta paguajë faturën

e Kim Jongut dhe delegacionit koreano-verior, që është strehuar në një hotel të vendosur në një zonë turistike, disa qindra metra larg delegacionit amerikan.

Por cilat janë pritshmëritë nga ky samit? Uashingtoni e ka bërë të qartë. "Ne nuk tërhiqemi nga kërkesa jonë për një Gadishull Korean krejtësisht të çarmato-

sur nga armët bërthamore. Kjo i shërben paqes dhe sigurisë në Gadishull dhe në gjithë rajonin", deklaroi Mike Pompeo.

Sinjalin se dëshiron t'i normalizojë marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara, Kim Jongu e dha pas takimit me homologun koreano-jugor, Moon Jaein. Pak ditë pas këtij takimi, Peniani shkatër-

roi galeritë nëntokësore ku besohet se ka kryer gjashtë teste bërthamore.

Analistët ndërkombëtarë thonë se nga takimi mund të pritet një ndërprerje totale e programit bërthamor nga ana e Koresë së Veriut, por vështirë që regjimi komunist të pranojë t'i shkatërrojë mbushjet e prodhuara deri më tani, të paktën jo të gjitha.

## Sondazhet parashikojnë balotazh në zgjedhjet presidenciale në Turqi



**ANKARA, 11 QERSHOR** - Sipas sondazheve, dy javë para zgjedhjeve parlamentare dhe presidenciale në Turqi, që do t'i japin presidentit, për herë të parë, kompetencat e aprovuara nga referendumi presidencial i vitit të kaluar, pritet që presidenti aktual Erdogan të jetë nën 50 % të votave që nevojiten për të fituar që në turin e parë. Sipas tyre, Erdogani është midis 42-48 %, shifër kjo e pamjaftueshme për ta kaluar raundin e parë pa

balotazh, megjithëse ai është më i favorizuar.

Instituti i sondazheve "Sonar" parashikon për Erdoganin rreth 48.3 % të votave, shifër në rritje në krahasim me atë të disa javëve më parë, që ishte 42 %. Nuk mungon as ndonjë sondazh që i jep pak më shumë se 50 %.

Mesa duket do të jetë Muharrem Ince, kandidat i CHP, ai që do të shkojë në balotazh me Erdoganin, sipas sondazheve.

Të gjitha institutet e kërkimit shënojnë një rritje për ish-ministrin e Brendshëm, Meral Aksener, i cili disa javë më parë shënonte rreth 20 %, ndërsa për kandidatin filokurd Selahaddin Demirtas, i cili ndodhet në burg, parashikohet rreth 10 %. Të paqarta edhe sfidat për zgjedhjet parlamentare, ku parashikimet tregojnë se AKP e Erdoganit dhe nacionalistët e MHP kanë rreth 44-45 %, ndërsa CHP dhe të tjerët rreth 38-40 %.

## Protesta në Serbi kundër çmimeve të larta të karburanteve

**BEograd, 11 QERSHOR** - Shoferët në disa qytete të Serbisë i ndaluan makinat e tyre në rrugë për të protestuar kundër çmimeve të larta të karburanteve.

Shumë autostrada dhe rrugë kryesore kanë qenë të bllokuara të hënën në Beograd, Novi Sad, Nish, Novi-Pazar dhe gjetkë. Çmimi i benzinës në Serbi, së voni,

është rritur në 1.29 euro për litër. Protestuesit kërkojnë që shteti të ulë tatimin mbi karburantet, i cili përbën rreth 55 për qind të çmimit. Ata thanë se çmimet duhet të

mbahen nën 1 euro për litër, në një vend ku paga mesatare është rreth 400 euro në muaj. Qeveria e Serbisë ka fajësuar tregjet globale për rritjen e çmimeve.





# VARGJET GRI

(Izet Abdyl, "Gri", Art Club "Rifat Kukaj", Prishtinë, 2018)

## Kosovare KRASNIQI

Në fushën e letërsisë, përsosmëria e artit letrar arrihet përmes poezisë. Poetët janë ata të cilët, përmes artit, magjinë e fjalës poetike e sjellin te ne. Poezia hynë në fushën e ndjenjave dhe poeti, pavarësisht sa përpiqet të gjykojë me arsye, nuk mund t'i ikë anës subjektive, asaj intime dhe asaj emocionale.

Poeti Izet Abdyl me tetë vëllimet e tij tashmë është i njohur për lexuesin shqiptar. Poeti Abdyl për herë të parë në fushën e gjerë poetike shfaqet me vëllimin e tij, "Fjalë zemre" (1995) dhe duke vazhduar me një intensitet mjaft të shpejtë dhe të gjallë, erdhi deri tek vëllimi i tij i radhës i titulluar "Gri". Në këtë vëllim poeti Abdyl vjen me lirikën e tij të bukura, duke na sjellë ajrin e vendlindjes, përshkrimin e natyrës, motivin e dhembjes për rininë që i ikën dhe buzëqeshjen e mikes së tij. Në trajektoren e tij poetike temat që trajtohen janë nga më të ndryshmet. Lirikat e përfshira në vëllim shprehin bukur gjendjen shpirtërore të poetit. Poeti zgjedh fjalët më të mira dhe ia kushton poezisë dhe poetëve: "Poetët nuk vdesin / Ata kthehen në yje / Rrugët i ndriçojnë".

Poezia për poetin është një syth pranverë, një harkim ylberi, buqetë lulësh, cicërimë zogu, e cila vjen sikur një rreze dielli që ngrohë:

Herë na vjen pa pyetur  
Na mbushë krenari  
Sot më erdh si dielli  
E bukura poezi

Vëllimi është i ndarë në katër cikle poetike, si: "Një pikë loti", "Seç më dogji malli", "Për buzëqeshjen" dhe "Sall një fjalë e mirë", ku e veçanta e këtij vëllimi është se çdo cikël poetik përcjell një mesazh tek lexuesi.

Se fjala është gjë e shtrenjtë, këtë e dimë të gjithë, mirëpo poeti për rëndësinë e saj na dëshmoi bindshëm edhe përmes vargjeve të poezisë së tij. Krijuesi lirik paraqet me sinqeritet mendimin e tij për fjalën, andaj në poezinë "Fjala" rrjedhin këto vargje:

Nga zjarri i shpirtit  
Fjalë e zjarrtë doli  
Flakëroi mendimi dritësuar  
Shkëlqeu si meteori

Këtë realitet ai e dëshmon në vargjet e kësaj poezie dhe vargjet nuk tingëllojnë vetëm si një deklaratë boshe, por si diçka reale dhe e pakontestueshme.

Ndër lirikën e tjera të bukura janë edhe poezitë me temë familjare, si poezia e tij për babanë, e cila jepet në dy variante. Në subjektin e poezisë së parë "Një fjalë e mirë", pos që paraqitet ditëlindja e babait të tij, portretizohet edhe karakteri i tij i ndershëm, si njeri që asnjëherë nuk e mundën smira dhe zilia:



Malli-pasuria  
Nuk të joshën kurrë  
Ndaj nderi e fjalëmirra  
Nuk t'u shqiten kurrë

Ndërsa në poezinë e dytë "Lis i fortë" janë kujtimet ato të cilat e ngacmojnë ta "portretizojë" babanë, si një lis të fortë, i cili qëndroi përballë shumë stuhive që i kishte përjetuar:

Qëndrove një shekull vertikalisht  
Si një lis i fortë  
Të rrahën furtuna e stuhi  
Veç u kalite më shumë

Atmosfera që paraqitet në poezi është pikëlluese nga vdekja e babait dhe poetit i sjell vetmi në

shpirt. Ai përmes vargjeve të tij kujton babanë, i cili ka ditur të "gatuajë" vetëm fjalë të mira ngado që ka shkuar.

## Lirika erotike

Ndjenja më e sublime e cila na ndjek gjithnjë është ajo e dashurisë. Gjithnjë kam menduar se vargjet lirike për dashurinë të bëjnë t'i ikësh zbrazëtirës brenda vetes, njëkohësisht janë vargjet më të dashura për lexuesin. Siç kuptohet nga titulli i këtij cikli "Për buzëqeshjen", vargjet e përfshira në këtë cikël si sferë kryesore do ta kenë buzëqeshjen e saj. Pra, frymëzimin e poetit e nxitë buzëqeshja. Asaj së cilës poeti i drejtohet në poezitë e tij del si objekt admirimi. Vasha portretizohet me të gjitha hiret e saj, flokët, gushën, faqet, buzët e syrin. Poezia titulluar "Portretizim" në pamje të parë të lë përshtypjen e një poeme të "copëzuar" në nëntutuj. Prandaj, këtu po i citojmë disa nga vargjet e kësaj "poeme":

## BUZËT

Si petale lulësh  
Buzët jeshil  
çilen e mshilen  
si një trëndafil

Dhe më tej:

## SYRI

Nën qerpikun tënd  
syri të vezullin  
ai shikim magjik  
sikur më përpin

Prania e "asaj" në shumë poezi të këtij cikli, përkatësisht të dy këto katrena të lartshënuara, na shpalosin situatën shpirtërore të subjektit lirik. Nuk mund të mos theksoj këtu freskinë, spontanitetin dhe bukurinë e këtyre poezive që vargjet e këtij cikli përcjellin. Subjekti lirik sikur përmes poezive të tij thotë "Poezitë e dashurisë nuk janë për t'u menduar, por për t'u jetuar".

## Përfundim

Në vargjet e këtij vëllimi poeti përdor llojet nga më të ndryshmet të strofave. Ashtu sikurse bota emocionale e tij, edhe në poezitë e tij vargu herë del i lirë, e herë i rimuar, por e rëndësishme është se poezitë kanë muzikalitet dhe ritëm të brendshëm. Ajo që të bën përshtypje është fakti se poeti eksploron edhe në ato poezi me ngjarje reale jetësore, siç është poezia e tij për babanë. Dhe, për fund, kur lexojmë poezinë e Izet Abdylit dhe laramanin e temave që shtjellon, mund të them se tek poezitë e këtij vëllimi vërejmë se çdo varg e çdo fjalë buron nga qartësia dhe brishtësia e shpirtit të tij.



HAJDIN MORINA

## FLUTURIM PA FUND

Fluturimi i natës ndërpritet  
Kur zemra e agmisë troket në xham  
Dhe unë kthehem nga bjeshkët  
Nga bujtinat plot tym e aspak gjumë

Fluturimi i ditës sakaq nis  
Mbi një degë të fjalës  
Ia thua ardhmërisë

Nuk e di cili zog je  
Nga cili planet  
Por tokën tonë të vogël  
Më të madhe ma bën

Pastaj ngjitesh qiejve përpjetë  
Nuk të vëren kush ku je  
Lumenjtë e shpirtit i shpejton  
Që të shembin shtyllat arkeologjike  
Të urrejtjes sonë

Mbi degë të fjalës  
Aq bukur pse hesht  
Pse fluturon aq shpejt...

## ME FANARIN E DRINIT

Ti Drini im i Bardhë  
Nuk buron nga zemra e pëlcitur  
E një bjeshke të Kosovës

Ti shpresa ime buron nga kujtimet e mia  
Nga mijëra ëndrra e beteja  
Nga mijëra bjeshkë të Shqipërisë

Asnjë matematikë nuk di të numërojë  
Sa dhimbje ua zbutë trimave nënave dhe lisave  
Sa gjëmë sa plagë Drini im i Bardhë

E sa varre i ke bleruar  
E sa sy vashash i zbukurove  
Me bukurinë e virgjërishme të Orëve të tua

Degët e kalbura që era i shkoq nga lisat  
Sa shpejt i përpin me të tuat valë  
Dhe diku rrugës ndonjë zjarri ia fal

I pastër i falesh Detit tonë

Prizreni nuk ishte as qyteti i Kukësit  
atëherë  
Nuk ish as ura bjeshka as mali  
Jetonte veç zjarri  
Kur e prite a të priti ty aty Drini i Zi

Drini im i Bardhë o Drini im i Zi  
Fanar i moçëm në shtigjet e mia  
Ti orakull mitik o Drin

Më rrjedh nëpër kujtime  
Dhe nëpër tokën time

As bardhë as zi  
Rrjedh bukur  
Rrjedh një  
Nëpër Shqipëri

Të kam lot  
Më ke kujtim  
O Drini im...

## NË KËRKIM TË JETËS

Jetën pa jetë brenda  
Nuk donim ta jetonim

Dhe bënim vargje e buzëqeshje  
Nga brumë i shpirtit

Kemi fluturuar pas orëve të poezisë  
Shkallëve dhe Bibliotekës së Filologjisë

Dhe për të vallëzuar deri në yje  
Fëmijët e Kosovës  
Ti tash nuk e jeton më kohën tonë të vdekshme

Gërshetin ta shprushë era  
Në një rreze lirie  
Në një valle të Flamurit

Sytë i paske harruar  
Në një agmi Kosove  
Që ma djeg mallin

Netëve të Ulpianës  
Kurrë nuk kemi menduar  
Se do të takohemi në një tjetër kohë  
Për ta dashur ndryshe njëri-tjetrin

## IKIM

Ikim dhe sërish ikim  
Takohe mi daku  
Në ndonjë bujtinë të shpirtit

Qielli nuk e mban shiun  
Sepse nuk është vjeshta jonë  
Që na i ruan pranverat  
Thellë nën barin e verdhë

Ikim nëpër shi  
Kjo vjeshtë nuk na ngroh  
Lirikën na shpon

## KOHË E GJITHMONSHME

Aty nuk është kjo koha jonë  
As shtëpia që pikon  
Por është koha e pambarim

Aty është koha e poezisë  
Në të cilën je flutur gjithmonë

Aty nuk është Drini i Bardhë i  
Ftohtësisë  
Por Drini i Zjarrtë i Dashurisë

Aty nuk ka vdekje as urrejtje  
Por ka jetë të përjetshme

Aty do të bësh dritë  
Sy i vargut tim





E jashtëzakonshme

## Blen akullore, por gjen brenda një gisht

Një person në Palermo kishte blerë një kaush me akullore në një bar dhe brenda gjeti një gisht të prerë. Ai u tmerrua dhe menjëherë ka njoftuar policinë. Nga marrja në pyetje e pronarëve dhe punonjësve të dyqanit të akullores doli se një nga punonjësit kishte prerë gishtin gjatë punës.



FOTO E DITES



Mbështetësit e socialdemokratëve në pushtet marrin pjesë në një tubim jashtë selisë së Qeverisë në Bukuresht. /AP/

E rrallë

## Braktis shkallët elektrike për të bërë "shou"

Policia kineze është në kërkim të "alpinistit" anonim, i cili të shtunën në mëngjes, më 9 qershor, mbi daljen e metrosë në Tuanjehu, në Pekin, është ngjitur në parmakun midis shkallëve të stacionit. I riu, i cili mbante në shpinë një çantë, jo pa vështirësi arriti të ngjitet në majë dhe humbi gjurmët para se agjentët e stacionit ta kuptonin se çfarë kishte ndodhur. Tani ai kërkohet për shkelje të rregullave të sjelljes për udhëtarët e transportit publik.



## BARSOLETA E DITËS



- Mos e lexove mbrëmë një sms?
- Qe m'i lype 50 euro borxh, a?!
- Po.
- Jo, s'e kam pa.



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 15:00

## "AVENGERS: Infinity War" 3D,

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

**Rolet:** Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlett Johansson, Tom Holland, Zoe Saldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

**Regjia:** Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 18:00

## "ISLE OF DOGS"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

**Regjia:** Wes Anderson



Në ora 16:00 dhe 20:00

## "DEADPOOL 2" (R)

Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

**Rolet:** Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesy, etj.

**Regjia:** David Leitch

Gjate vikendit 19 dhe 20 maj, "DEADPOOL 2" do te shfaqet ne ora 13:00 dhe 20:00.




Në ora 22:00

## "I FEEL PRETTY"

Komedi; 1 orë 50 min

**Rolet:** Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper with Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.

**Regjia:** Abby Kohn & Marc Silverstein



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), **fb: Kino ABC.**

<p><b>DASHI</b> Energjia juaj dhe sensi i humorit do të shërbejnë si bateri për ata njerëz pranë jush që ndihen të plogësht sot.</p>	<p><b>DEMI</b> Sot është dita ideale për të zgjidhur një problem të lënë pezull ndërmjet jush dhe një personi tek i cili besoni shumë.</p>	<p><b>BINJAKËT</b> Mbase ka ndodhur një keqkuptim midis jush dhe miqve tuaj, por kjo gjë nuk ka pse pengon një projekt të nisur bashkërisht.</p>	<p><b>GAFORRJA</b> Sot duhet të tregoheni të drejtë drejtë me ata persona që nuk kanë pasur besim tek ju. Mos u fshihni pas ndonjë batute nënkuptuese.</p>	<p><b>LUANI</b> Nuk keni në dispozicion mjetet e duhura për të arritur një qëllim të caktuar. Me kalimin e kohës do të shihni më qartë këtë gjë.</p>	<p><b>VI RGJËR ESHA</b> Mbase sot nuk do ta kuptoni, por ajo që keni bërë kohët e fundit do të ndikojë shumë negativisht në raportin tuaj me partnerin.</p>
<p><b>PESHORJA</b> Edhe pse keni shumë pritshmëri, dita e sotme nuk do të jetë realizimi i tyre. Mbase ju duhet më shumë impenjim për t'i arritur synimet tuaja.</p>	<p><b>AKREPI</b> Sot duhet të pranoni që jeni humbës në një çështje të caktuar. E rëndësishme është të reflektoni për gabimet tuaja.</p>	<p><b>SHIGJETARI</b> Sot nuk jeni ngritur me humor të mirë dhe çdo gjë ju duket sikur ka ngecur. Pasojat e sjelljes suaj do t'i kenë edhe miqtë.</p>	<p><b>BRICJAPI</b> Koha juaj kalon shumë më mirë me miqtë se me partnerin. Diçka ka ndodhur dhe për këtë thjesht po shmangeni pa kërkuar shpjegime.</p>	<p><b>UJORI</b> Propozimet tuaja të fundit në ambientin e punës po priten shumë mirë nga epororët. Mbase kjo është ajo që duhet të bëni dhe në të ardhmen.</p>	<p><b>PESHQIT</b> Sot nuk do të keni shumë mundësi për ta takuar personin që po kërkoni. Është mirë të synoni diçka tjetër dhe të mos fiksoheni kot.</p>



## Himni i Botërorit një sukses, Era Istrefi shkëlqen sërish



Tanimë është publikuar videoklipi zyrtar i Botërorit Rusi 2018, ku këndon edhe shqiptarja Era Istrefi. Duket se kjo këngë është pritur mjaft mirë nga të gjithë, pasi vetëm dy ditë pas pub-

likimit kënga ka arritur të ketë mbi 12 milionë e gjysmë klikime në "Youtube". Ky është suksesi më i madh i Erës deri më tani. Era Istrefi u bë e njohur në tregun ndërkombëtar me këngën "Bonbon".

## Martohet Keegan-Michael Key



Keegan-Michael Key dhe Elisa Pugliese janë zyrtarisht të martuar. Aktori 47-vjeçar dhe e dashura e tij u kurorëzuan në Nju Jork. Keegan dhe Elisa shfrytëzuan rrjetet sociale për ta zbuluar lajmin

e mrekullueshëm. Çifti ka njoftuar për fejesën në nëntor të vitit të kaluar. Ata fillimisht e zbuluan lidhjen e tyre në mars të vitit 2016, por e mbajtën marrëdhënien e tyre shumë private.



## Kim Kardashiani vazhdon t'ia festojë burrit ditëlindjen

Kim Kardashiani po vazhdon festën për burrin e saj Kanye West i cili të premten festoi ditëlindjen. Festa për të nuk ka mbaruar edhe pas dy ditësh. Familjarët dhe miqtë e tij kujdesen që kjo ditëlindje të

jetë e paharruar për të. Ditëlindjen e 41-të ai festoi bashkë me personat më të dashur për të, ndërsa ishte Kendall ajo e cila postoi në rrjete sociale imazhe të tortës për ditëlindjen e tij.

## Bella Thorne, për pushime në Hawaii



Bella Thorne nga fillimi i qershorit i ka nisur pushimet verore. Ajo aktualisht po qën-

dron në destinacionin e bukur Hawaii dhe këtë përvojë po e dokumenton me postime në "Instagram".



# Parimet e Luftëtarëve që ju tregojnë rrugën e jetës kuptimplotë

Jeta bashkëkohore duket se po ndihmon të fitosh gjithçka për asgjë, pa sakrificë ose dhimbje, por nuk arrin të mësohet se si t'i tejkalojë sfidat e pashmangshme të jetës. Dhe, duke parë më afër, premtimi i lartë i suksesit pa përpjekje është me të vërtetë një gënjeshtër që apelon për të menduarit dembel dhe ju çon drejt besimit që mund të fitoni diçka kuptimplotë pa punuar për të. Më keq, ky lloj i të menduarit ushqen të drejtën dhe një ndjenjë të rreme të epërsisë. Kur sukcesi nuk vjen, krijon një zemërim të fortë që mund t'ju shkaktojë humbje besimi të vetja dhe bota. Por nëse mund të lidhni mençurinë dhe forcën tuaj, mund të arrini një version më të fortë dhe më të aftë për veten.



lueshme për të jetuar në mënyrë autentike duke tejkeluar frikën tonë.

## 1-Të jetosh me guxim

Në fillim të çdo janari, miliona njerëz bëjnë rezymenë për Vitin e Ri që të ndryshojnë jetën e tyre, por shpesh e shohin angazhimin e tyre të fillojë të dobësohet në shenjën e parë të vështirësive që shfaqet. Luftëtari e përqafton këtë vështirësi dhe e përdor atë për t'u bërë më i fortë, duke e parë atë si një burim fuqie për çdo centimetër përpara drejt qëllimeve, frikës së kaluar dhe suksesit. Stephen Hawking e personifikoi këtë koncept, pasi ai u diagnostikua me sëmundjen e Lou Gehrig në moshën 21 vjeçare dhe ju tha se nuk do të jetonte më shumë 25 vjeç. Ai përfundoi duke

jetuar edhe për 56 vjet, edhe pse trupi i tij u shkatërrua nga sëmundja që e kufizonte atë në një karrige me rrota, të paafte për të lëvizur dhe vetëm duke qenë në gjendje të komunikonte përmes një kutie zanore. Përkundër trajtimit me një kusht që do të kishte shtyrë shumicën prej nesh në depresion, Hawking kurrë nuk e konsideronte veten të hendikepuar dhe kaloi të mësuarit e tij të gjallë rreth sëmundjes së tij. Ai më vonë u bë një ekspert fizike e astronomie dhe solli përvojën e tij në kërkimet e vazhdueshme, duke u bërë gjithashtu një autor i përsosur, profesor dhe fizikan. Në jetë, pengesat janë konstante, por simboli i luftëtarit zbulon se ke një zgjedhje dhe ajo është: "Lejo që ti të mposhtesh në shenjën e parë të vështirësive ose zgjidh të përballesh me shumë guxim".

## 2-Të jesh i gatshëm të përballesh

Arketipi i luftëtarëve tregon se duhet të jeni të gatshëm të përballesh me dragonjtë tuaj dhe t'i vrisni ata. Dragonjtë janë metafora për frikërat që lindin në rrugën drejt qëllimeve apo ëndrrave tuaja. Paaftësia juaj për të kërkuar një ngritje, për t'u përballur me një dhunues në shkollë, për të trajtuar në mënyrë efektive pasiguritë tuaja, për të plotësuar të metat tuaja, për të pranuar dobësinë tuaj të lindur, për t'u marrë me traumën tuaj ose për të ndjekur planet tuaja janë të gjitha shembujt e dragonjve që duhet të ballafaqohet dhe të vriten. Kjo nuk do të thotë që ju duhet të jeni konfrontues, por duhet të stërviteni që të jeni të gatshëm të përballoni problemet tuaja. Nëse

jo, mund të bëheni skllav të dyshimeve tuaja dhe të detyroheshi të jetoni nën potencialin tuaj.

Sot, zgjidhni diçka që ju keni qenë duke e shmangur dhe ndërmerri veprime të vogla, të matura, në drejtim të trajtimit me të. Siç e bëni, do të zbuloni se dragoi juaj nuk është aq i fuqishëm sa mendoni, gjë që do t'ju japë besimin për të trajtuar çështje më të mëdha që ju kanë mbërthyer.

## 3-Lufta për atë që është e drejtë

Gjatë luftës me Gjermaninë naziste, Winston Churchill tha: "Ju duhet të luftoni edhe kur nuk ka shpresë për fitore, sepse është më mirë të vdisni se sa të jetoni si skllav".

Kjo vërejtje u bë kur Gjermania kishte një avantazh të fortë ushtarak mbi Britaninë e Madhe, por Churchill ishte i palëkundur në kundërshtimin e tij ndaj nazistëve. Edhe kur nazistët i ofruan Britanisë së Madhe një paqe të ndershme në këmbim për t'i dhënë fund luftës, Churchill mbeti i palëvizur.

Ai shfaqti një sjellje arketipike të prototipit të luftëtarit, sepse ai e kuptoi atë çfarë rrezikonte. Ai besonte me gjithë zemrën e tij se ishte në anën e drejtësisë në atë që ishte një përplasje e qartë midis të mirës dhe të keqes. Për Churchill, zgjedhja e vetme që mund të bënte ishte lufta përgjithmonë.


E thënë ndryshe, është e rëndësishme të mendoni se ju kujtoheni për luftën që ju kryeni, por edhe për luftimet që nuk i merrni përsipër. Gjithmonë pyesni veten nëse çështja juaj është në anën e drejtësisë dhe në shërbim të një thirrjeje më të lartë.

Dhe, sapo të zgjidhet dilema juaj, atëherë luftëtari brenda jush mbetet i patundur pa marrë parasysh koston.

Mendoni për këtë: Nëse Churchill do të ishte lëkundur dhe s'do mendonte për paqen, sa e ndryshme do të ishte bota sot? (gazeta-Shqip.com)







<b>Autor: GAZMEND MORINA</b>	FUTBOLLISTI NË FOTO (shqip.)	KËNGËTARE E FAMSHME BRITANIKE	SHKRIMTARI ..... KUKAJ	ZBRITJA E AEROPLANIT NË TOKË	SHEGA	BASHKËT.	IDRIZ SEFERI	ISH POLITIKANI BRITANIK ROBIN ... VEND I HAPUR NË MURIN E NJË SHËTËPIE (sh.shq.)	DAMARI I GJAKUT	NJË PLANET (shq.)	MODERATORI BENET ....
SIGURI E CILA I JEPET DIKUJT PËR NJË TË DREJTË QË I TAKON											
KËNGËTARJA SOPJANI						GRILLI ZANORE					
ARBITRI							LLOJ HELIKOPTERI SHTET (fr.)				
							KËNGËTARJA ADELINA ..... ISMET TOTO				
BARI PELASH (shq.) VITI I RI KINEZ						SHTET NË EVROPË (pashq.) SHUMË I MADH, GOXHA (krah.)					REPER AMERIKAN
BASHKËT.		PORTIERI SPANJOLL PEPE .....	ENË TENEQEJE PËR TË MBAJTUR QUMËSHT DY BASHKË.							ZANORE INSTITUTE PUBLIC ACCOUNTANTS	
BASKETBOLLISTI YNË ..... LUCA							TRAJNERI TURK FATIH ..... KËNGËTARJA ... KIM				

<b>EPOKA E RE</b>	PLAK I RRËGJUAR NGA MENDTË	SIGURIM I GJËRAVE TË NEVOJSHME PËR JETESË	SHKRIMTARJA KAMBERI	FRYMA	"RISANI"	AKTORI I FAMSHËM ... LI "ASHTU QOFTË" (mysl.)		ANNA LEE ISH FUTBOLLISTI ANGLEZ MAJKËLL (shqip - shq.)		LLOJI, SOJI MJET SHPËRTHYES		
LËNDË JOORGANIKE QË GJENDET NË KOREN E TOKËS (shq.)							VAJ KUZHINE QË PRODHOHET NË SHQIPËRI AKTORJA ..... CAHANI			AJKA E QUMËSHTIT	KYÇ I TAKOJ	
ANËTARËSIM NË NJË PARTI POLITIKE							RRAFSHIM ISH FUTBOLLISTI ÇEK JANKULOVSKI (MILAN)					EVERTON I EMËRUAR
AKTORJA E NJOHUR .... REID					KUZHINË PRANË XHAMISË RRËMUJË				EMËR MASHKULLI TURK FAREFIS (bised.)			
NEVOJË E THEKSUAR QË KEMI PËR TË NGRËNË				KËNGËTARJA ... OKSA NËNA			ESTONIA, NORVEGJIA I KËTJË ÇASTI, I KËSAJ KOHE		SHPEND I EGËR, ME TRUP SA TË GJELIT KLUB FUTB. NË ITALI			POETJA AHMETI
KUNDREJT MASHKULL					BËRJA MË I RI SHIU I IMËT					GRIMCË MOLEKULARE E SHOQJA E AGAIT		
<b>EPOKA E RE</b>	AI QË BËN DEMAGOGJI	BISKOTË E GATUAR ME ARRA (shq.) SIMBOL I FESË MYSLIMANE						REGJISORI QOSJA KULAÇE			EMINE (perkdh.) AGIM TEJECI	
PJESË E MEKANIKËS QË STUDIOU LIGJET E LËVIZJES SË TRUPAVE							ILION LIKA ZANORE			GATESË BANORE E NJË SHTETI SKANDINAV		
"M" në mes të dy "E"				AZEM GALICA QYTET NË KOSOVË			SHTËGTARET PËRFUNDIM NË SHAH				JO (ang.) BASHKËT.	
MARK ANTONI			LLOJ PESHKU (shq.) KRYEHOXHA				NË ANË, NË BRINJË TË DIÇKAJE PASURIA E PATUNDSHME (vjet.)				QYTEZË SHQIPTARË NË MAL TË ZI POPULL (turq.)	
KËNGËTARJA ..... MIMANI					DASHNOR (turq.) THIRRJE E MYEZINIT				ZULMË FORTESE		ALI ALIU GËZIM I MADH	
BASHKËT.		BREJTËS I VOGËL KRAHINË NË SHQIPËRI			BABALLARË ZANORE			"KENIA" RENUIM, ZET		INSTITUTE HISTORICAL RESEARCH		NUK KA (bised.)
BANOR I NJË SHTETI AZIATIK						SMIRË JEMENI, ANGOLA				NOTË MUZIKORE DY BASHKË-TINGËLLORE		BASHKËT. ISMET MUNISHI
SHKRONJË GREKE					ADEM JASHARI ZANORE		MJET PËR BARTJE NË VISE MALORE BASHKËT.					
URINARY TRACT INFECTIONS				METODË STUDIMI						EMBLEMA		



# Kush i dikton mekanizmat e botës? Njihuni me protagonistët G7-s

Dihej që përpara sesa të zhvillohej se samiti i radhës i G7-s do të ishte i tensionuar dhe tejet i vështirë, por më shumë sesa pritshmëritë, këtë e vërteton një foto e publikuar nga llogaria zyrtare në Instagram e Kancelares gjermane, Angela Merkel.

Një foto ku të gjithë pjesëmarrësit shfaqen në këmbë, rreth tryezës ku qëndron i ulur presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump. Por cilët janë personat e shfaqur në foto?

**1-Donald Trump, president i Amerikës:** Trump tronditi aleatët e Shteteve të Bashkuara, kryesisht Bashkimin Europian, Meksikën dhe Kanadanë, kur shpalli së fundi vendosjen e tarifave të importeve të çelikut dhe aluminit nga këto vende, respektivisht me 25% dhe 10%. Aleatët nuk qëndruan duarkryq dhe kërcënuan për masa hakmarrëse, një mosmarrëveshje që mbizotëroi edhe në samit, duke e lënë presidentin amerikan shpeshherë të izoluar. Trump u largua më herët nga të tjerët, duke u ankuar se Amerika i ngjante një "arke kursimi të cilën po e zhvasnin të gjithë". Por, gjithsesi, marrëdhëniet e tij me udhëheqësit e tjerë të G7-s mbeten në nivele maksimale.

**2-John Bolton, këshilltar për Sigurinë Kombëtare i Trumpit:** Janë mbushur vetëm 3 muaj që kur ai u emërua në postin e këshilltarit më të lartë të sigurisë në kabinetin e presidentit Trump, por John Bolton pati padyshim impaktin e tij. Një prej argumenteve të presidentit për vendosjen e tarifave ndaj aleatëve kishte pikërisht



natyrën "për shkaqe të sigurisë kombëtare", një pikëpamje që Boltoni e ka mbështetur fuqishëm.

### 3-I paidentifikuar.

**4-Shinzo Abe, kryeministri i Japonisë:** Abe është vendosur përballë një presioni gjithnjë e më të madh për t'iu bashkuar masave të përbashkëta hakmarrëse kundër tarifave të Amerikës. Kjo e vendos atë në një pozicion të vështirë, pasi është përpjekur të kultivojë një marrëdhënie të ngrohtë me presidentin Trump, ndërsa të dyja palët janë takuar të paktën 10 herë që kur ky i fundit është zgjedhur në krye të Shtëpisë së Bardhë.

**5-Yasutoshi Nishimura, zv.sekretari i kabinetit japonez:** Deputeti nga partia qeverisëse

e Japonisë ka punuar dikur në Ministrinë e Tregtisë ndërkombëtare dhe Industrisë.

**6-Angela Merkel, Kancelare e Gjermanisë:** "Zonja e hekurt" e Europës ka qenë në ballë të bisedimeve, në përpjekje të sheshimit të dallimeve në samit, siç e vërteton edhe fotografitë. Merkel me sa duket ka hedhur idenë e ngritjes së një mekanizmi për të zgjidhur mosmarrëveshjet tregtare mes Shteteve të Bashkuara dhe aleatëve gjatë së premtes. E pyetur gjatë samitit mbi marrëdhënien e saj me presidentin Trump, Merkel është shprehur se dy udhëheqësit nuk bien gjithmonë dakord, por gjithsesi flasin me njëri-tjetrin. "Mund të them se ruaj ende një marrëdhënie tejet të hapur dhe të drejtpërdrejtë me presidentin amerikan".

**7-Emmanuel Macron, presidenti francez:** Macron u përfshi në një "luftë cicërimash" në Twitter me presidentin Trump mbi tarifën, vetëm pak orë përpara nisjes së samitit, duke nxitur disa të dyshonin nëse realisht "bromanca" mes tyre kishte marrë fund. Pavarësisht kësaj, ata u panë në gjendje të shëndoshë, ndërsa ekipi i presidentit Macron tha se bisedimet e tij me Trumpin kishin qenë "të sinqerta dhe të vendosura".

**8-Theresa May, kryeministre e Britanisë së Madhe:** Në një telefonatë të javës së kaluar, ajo i tha presidentit Trump se i shihet tarifën amerikane "të pajustifikuar dhe thellësisht zhënjyese". Por, gjatë samitit ajo mbajti një ton më pajtues, duke nxitur udhëheqësit e tjerë të tërhiqeshin nga mundësia reale

e të shkaktuarit një luftë të mundshme tregtare.

**9-Larry Kudlow, drejtor i Këshillit Ekonomik Kombëtar amerikan:** Këshilltari më i lartë ekonomik i presidentit Trump ka dalë në mbrojtje të lëvizjes së shefit të Shtëpisë së Bardhë për rritjen e tarifave dhe thotë se "bosi i tij" nuk duhet parë si përgjegjës për nxitjen e konflikteve tregtare me aleatët e Amerikës. Kudlow shprehet gjithashtu se thirrja e presidentit për të eliminuar të gjitha tarifën mes vendeve të G7-s është "mënyra më e mirë për të promovuar rritjen ekonomike". Fotoja e mësipërme është publikuar nga Merkel në rrjetin social Instagram, por e njëjta situatë nga një kënd tjetër është hedhur në "Twitter" edhe nga presidenti Macron.

(gazeta-Shqip.com)





**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com

**Sport**

**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

POLAND - LITHUANIA

1

JAPAN - PARAGUAY

1

LAHTI - FC HONKA

1

# MKRS-ja nuk e harron sportin e Suharekës

Ministri Kujtim Gashi ka konfirmuar të hënën se ministria që ai e drejton nuk e ka harruar asnjëherë sportin në Komunën e Suharekës. MKRS-ja përkrah ndërtimin e stadiumit në fshatin Studençan si dhe përfundimin e fazës finale të stadiumit të qytetit. Ndërkohë, pritet të investohet edhe në stadiumin e Mushtishtit

## "Epoka e re"

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, e ka vizituar të hënën Komunën e Suharekës, ku është pritur nga kryetari Bali Muharremaj. Ministri Gashi dhe kryetari Muharremaj me këtë rast kanë nënshkruar tri memorandume, dy prej të cilave në fushën e sportit. Në memorandumin e parë përfshihet ndërtimi i stadiumit në fshatin Studençan, kurse në memorandumin tjetër përfshihet përfundimi i fazës finale të stadiumit të qytetit.

Ministri Gashi ka premtuar se do të ndajë buxhet edhe për ndërtimin e stadiumit në Mushtisht. "Memorandumi i parë ka të bëjë me stadiumin në Studençan, ku ka qenë edhe premtimi imi. Jemi pajtuar ta fillojmë këtë projekt dhe së shpejti do ta fillojmë fazën e parë të tij. Po ashtu, jemi pajtuar ta përfundojmë edhe fazën e fundit të projektit të stadiumit të qytetit. I premtova kryetarit që do të ndajmë mjete financiare edhe për stadiumin në Mushtisht, pasi buxheti është shtuar për 9 milionë euro. Më vjen mirë që për herë të parë Ministria e Kulturës ka mbi 40 milionë euro", ka thënë ministri Gashi. Me nënshkrimin e këtyre memorandumëve është ndarë i kënaqur edhe kryetari Bali Muharremaj, pas komuna që drejton



ai përfiton projekte në vlerë mbi 600 milionë euro.

## MKRS-ja mbështet mundësit Edon dhe Egzon Shala

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, përveç nënshkrimit të memorandumeve në Komunën e Suharekës, të hënën ka nënshkruar edhe dy memorandume bashkëpunimi me mundësit Edon dhe Egzon Shala. Në bazë të memorandumëve parashihet që sportistët të përfitojnë nga 10 mijë euro për shpenzimet e përgatitjeve për Lojërat Olimpike "Tokio 2020". Mjetet financiare mundësit do t'i shfrytëzojnë për

akomodim, stërvitje dhe ushqimet specifike që janë të parapara për sportistët.

Ministri Gashi ka thënë se me këtë përkrahje të drejtpërdrejtë për dy mundësit, MKRS-ja po tregon se gjendet gjithmonë pranë sportistëve që kanë talent dhe tregojnë gatishmëri për të arritur suksese dhe rezultate në sportet e tyre përkatëse. Mundësit Edon dhe Egzon Shala e falënderuan ministrin dhe MKRS-në për këtë mbështetje dhe u zotuan se do ta japin maksimumin për ta prezantuar veten, por edhe shtetin e Kosovën në mënyrën sa më të mirë të mundshme në garat ndërkombëtare në të cilat do të marrin pjesë.

## SHKURT

### Khudistët nisin përgatitjet për "Tarragona 2018"

Ekipi i khudos në krye me kampionen olimpikë Majlinda Kelmendi ka filluar përgatitjet për Lojërat Mesdhetare "Tarragona 2018". Edhe pse Kelmendi në "Tarragona 2018" do të jetë në cilësinë e trajneres, në Poreç ndodhet edhe ekipi që merr pjesë në Lojërat Mesdhetare. Kampionia evropiane, Nora Gjakova, nënkampionia Distria Krasniqi, Akil Gjakova, Loriana Kuka dhe Laura Fazliu janë pesë garuesit e khudos që do të kërkojnë medalje në "Tarragona 2018". Ata po përgatiten bashkë me trajnerin kampion olimpik, Driton Kuka. Shpenzimet e përgatitjeve të tyre do të mbulohen nga Komiteti Olimpik i Kosovës. "Përgatitjet përfundimtare për Lojëra Mesdhetare filluan në Kroaci, Poreç. Kampionia Olimpikë tanimë ka filluar stërvitjet serioze dhe besoj se në korrik do t'i bashkohet ekipit drejt Lojërave Olimpikë. Pos Majlindës, në Poreç po merr pjesë i gjithë ekipi Olimpik me Kampionen Evropiane, Norën e Nënkampionen Evropiane, Disin", ka shkruar Kuka në "Facebook".

### Beqa kualifikohet për Botëror

Gentiana Beqa ka fituar garën e fitnesit "IFBB Elitë Pro Diamond Cup Espinho" të mbajtur në Portugali. Këtë lajm e ka dhënë menaxhmenti i saj përmes një komunikate për media. "Gentiana Beqa rrëmben edhe një kupë në Portugali, kualifikohet për Kampionat Botëror, i cili do të mbahet në Cancun, Meksikë, në nëntor 2018", thuhet në komunikatë. Më tutje, thuhet se javë më parë në Madrid të Spanjës ajo ka fituar vendin e parë në 'Elite Pro Diamond Cup Madrid', duke përfaqësuar Kosovën në shtetin spanjoll.

### Karateistët përgatiten në Bogë për "Tarragona 2018"

Kombëtarja e Kosovës në Karate do t'i zhvillojë përgatitjet në Bogë të Pejës për Lojërat Mesdhetare "Tarragona 2018". Ekspedita e karatesë do të vendoset në Hotel Magra prej 13-19 qershorit, kurse shpenzimet e përgatitjeve i mbulon Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK). Herolind Nishevcu, Alvin Karaqi, Orges Arifi, Fortesa Orana dhe Adelina Rama janë pesë garuesit e karatesë që do të synojnë suksese në Tarragona 2018. Përzgjedhësi i kombëtares së karatesë, Isak Curri, beson në fitimin e medaljeve. "Përgatitjet do të na ndihmojnë shumë. Të gjithë karateistët tanë kanë gjasa për medalje. Shumëçka varet edhe nga shorti, andaj uroj të kemi fat në short", ka thënë Curri.

# Haradinaj viziton familjarët e Vokrrit

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, me kabinetin qeveritar vizituan sot familjarët e Fadil Vokrrit. Haradinaj i shprehi edhe një herë ngushëllime familjes. Ai ka thënë se Vokrrin e kemi humbur të gjithë, pasi ai ka qenë i të gjithëve dhe jo vetëm i familjes. Haradinaj tutje shtoi se është mjaft i lumtur që ceremonia e varrimit është organizuar në mënyrën më të mirë të duhur, ashtu siç Fadil Vokri e ka merituar. Ndërkaq, zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, shtoi se vdekja e legjendës së futbollit të Kosovës është një humbje e madhe dhe se Vokri ka qenë një njeri i mirë dhe do ta kujtojmë me krenari. Së bashku me Haradinajn dhe Behgjet



Pacollin ishin edhe ministri i Integritimit Evropian, Dhurata Shëndetësisë, Uran Ismajli, ministrja e Hoxha, si dhe disa ministra të tjerë.



## Hamiltoni: Vështirë të konkurrohet me Ferrarin

LONDËR, 11 QERSHOR - Lewis Hamiltoni ka dalë i zhgënjyer me vendin e pestë në Çmimin e Madh të Kanadasë, vend i cili bëri që britaniku të parakalohej në renditjen totale nga Vetteli me 1 pikë. "Nëse nuk punojmë mirë do

të jetë e vështirë ta mposhtim Ferrarin. Ata kanë një potencial të madh. Duhet ta mbajmë kokën ulur e duhet të punojmë", ka deklaruar Hamiltoni pas garës në Kanada. Por për Hamiltonin edhe vendi i pestë për të ishte

shumë në këtë garë, pasi problemet me makinën mund të kishin bërë që ai të mos e kishte përfunduar garën. "Fuqia e motorit vijonte të ngrihej e të ulej në mënyrë të çuditshme. Kisha frikë se mund të ndodhte

ndonjë prishje por, fatmirësisht, ia dola ta përfundoja garën", ka deklaruar piloti i Mercedesit, duke shtuar se: "Imagjinoja një fundjavë ndryshe, por për shkak të këtij problemi mund të kishte përfunduar edhe më keq".



## Batatina: Me Sokolin synojmë Evropën

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Llapi është duke u organizuar mjaft mirë për edicionin e ri në elitën e futbollit të Kosovës. Skuadra "bardhekaltër" nga Podujeva ka marrë trajnerin e mirënjohur Bylbyl Sokolin. Ndërkohë në postin e drejtorit sportiv është emëruar Tahir Batatina, i cili deri në edicionin e sapopërfunduar ishte në pozitën e trajnerit. Puna e Batatinës si drejtor sportiv menjëherë ka filluar të ketë efekt, pasi ai ka rikthyer në skuadër dy lojtarë llapjanë: Bledar Hajdinin dhe Fiton Hajdarin. Llapit i është bashkuar edhe mesfushori fantastik i Dritës, Arbnor Ramadani, sulmuesi nga Shqipëria, Albi Çekići, si dhe Ardian Hoti. Batatina ka arritur t'i "blindoje" edhe yjet si Mentor Zhdrella dhe pjesën tjetër të rëndësishme të skuadrës. "Llapi ende nuk e ka mbyllur sa iu përket transferimeve për këtë afat kalimtar. Qëllimi ynë është të përfordhem edhe me katër ose pesë futbollistë, ku me shumicën prej tyre kemi arritur marrëveshje dhe pritet gjatë ditëve të ardhshme



t'i bëjmë zyrtare", ka thënë Batatina për "Telegrafin". Llapi do të përfordhet edhe më shumë në fazën defensive dhe atë ofensive. Batatina ka treguar edhe objektivat e skuadrës së tij për edicionin e ardhshëm ku synojnë trofe dhe daljen në Evropë. "Me ardhjen e trajnerit Bylbyl Sokoli është rritur

edhe motivi te skuadra. Si skuadër stabile në vitet e fundit ku kemi përfunduar vetëm në pjesën e epërme të tabelës, ne synojmë të vazhdojmë me të njëjtin ritëm. Llapi do të jetë konkurren në dy frontet, në kampionat dhe në kupë, pasi synojmë daljen në Evropë", ka përfunduar Batatina.

## Kush do të shkëlqejë në Kupën e Botës 'Rusi 2018'?

MOSKË, 11 QERSHOR - Rusia këtë vit do të shkëlqejë si kurrë më pak në aspektin futbollistik. Për një muaj në fushën e lojës do të zbresin yjet e këtij sporti dhe spektakli është i garantuar. Pa dyshim në plan të parë do të jetë sfida e përjetshme mes Lionel Messit dhe Cristiano Ronaldos që do të kenë mbi vete sytë e miliarda tifozëve në mbarë botën. Si për argjentinasi, po ashtu edhe për portugezin ky edicion i Kupës së Botës mund të jetë i fundit në karrierën e tyre dhe si pasojë mund të jetë edhe shansi i fundit për ta për të pasuruar më shumë palmaresin e tyre plot trofe. Por është dikush që dëshiron të lërë pas sa më shpejt Botërorin e fundit, dhe ai është Neymar, i cili, për shkak të një dëmtimi, nuk ishte në fushën e lojës ditën që Gjermania shkatërroi Brazilin 7-1 në gjysmëfinale. Brazili do të kërkojë të tregojë se është ai pasuesi i Messit e Ronaldos.

Edhe Luis Suarez në 2014-n kujtohet për kafshimin ndaj Chiellinit, një çmenduri që i kushtoi 9 ndeshje shkualifikim me Uruguain dhe 4 muaj pezullim. Ylli tjetër i këtij Botërori që ka pas vetes një komb të tërë është Mohamed Salah, i cili



nuk është në formën më të mirë pas dëmtimit të pësuar në finalen e Ligës së Kampionëve. Egjiptiani ka pak gjasa ta fitojë Kupën e Botës, por ai po përjeton sezonin më të mirë të karrierës së tij: 44 gola me Liverpoolin e katër me Kombëtaren, shifra vërtet impresionuese. Franca dhe Anglia i kanë shpresat e tyre te Antuan Grizman e Harry Kane. Skuadra e Deshamps është e mbushur plot me talente, por ai që do të ketë vëmendjen më të madhe

do të jetë pikërisht sulmuesi i Atletico Madridit. Ndërsa sulmuesi i Tottenhamit do të kërkojë të festojë në mënyrë më të mirë rinovimin me klubin londinez dhe t'i dhurojë një trofe Britanisë së Madhe që nuk fiton një Kupë Bote që nga viti i largët 1966. Andres Iniesta, pas largimit nga Barcelona, e pret një pension i artë në Japoni, por më parë 34-vjeçari spanjoll do të kërkojë ta fitojë edhe trofeun e fundit të Kupës së Botës me kombëtaren e tij.

### SHKURT

#### Levante, e gatshme ta shesë Sadikun

Armando Sadiku nuk bën pjesë në planet e Levantes për edicionin e ri, ndaj duhet të kërkojë një skuadër të re. Lajmi është bërë me dije nga "Marca". Sulmuesi kuqezi ka kontratë me këtë skuadër deri në vitin 2020, por ai nuk bën pjesë në planet e trajnerit Paco Lopez, prandaj është vënë në shitje, por ekziston mundësia të huazohet.

#### Federeri dhe Williamsi, milionerët e tenisit

Suksesi i Rafael Nadalit në "Roland Garros" në terma financiarë përkthehet me 2 milionë e 200 mijë dollarë, shumë kjo që shkon menjëherë në llogarinë e tij. Çmimi i fundit i fituar nga tenisti spanjoll e çon shumën totale të përfutur gjatë karrierës së tij në 100.251.598 dollarë. Vetëm Roger Federeri dhe Novak Djokoviçi kanë pasur më shumë të ardhura se Nadali në karrierën e tyre, zvicerani 116.222.182 dollarë dhe serbi 110.854.762 dollarë. Në listën e më të pasurve të tenisit vijnë më pas Andy Murray (60.807.644), Pete Sampras (43.280.489), Andre Agassi (31.152.975), David Ferrer (31.038.623), Stanislas Wawrinka (30.976.225), Tomas Berdych (28.845.972) dhe Boris Becker (25.080.956). Sa iu përket femrave, ka akumuluar më shumë të ardhura gjatë karrierës Serena Williamsi, plot 89.722.779 dollarë. Tenistja amerikane ndiqet nga motra, Venus Williams, me (39.990.543), Maria Sharapova (30.828.060), Kim Clijsters (24.442.340) dhe Lindsay Davenport (22.166.338).

#### Oweni favorizon Brazilin

Ish-sulmuesi i Anglisë, Michael Owen, e ka favorizuar Brazilin për ta fituar Kupën e Botës "Rusi 2018". "Franca ka ekip shumë të mirë, por unë jam skeptik për të. Spanja dhe Gjermania gjithashtu janë të forta, por unë mendoj se Brazili është skuadra më e fortë e Botës. Ajo është favorite. Ky është parashikimi im", ka thënë Owen.

#### PSG-ja insiston për Kanten

Trajneri Thomas Tuchel e do të Paris Saint-Germaini mesfushorin e Chelseat, N'Golo Kante, raporton "Sun". Agjenti i francezit, Karim Douis, raportohet se tashmë është takuar me drejtorin sportiv të PSG-së dhe po mundohen të arrijnë një marrëveshje që dy herë kampioni i Premierligës të kthehet në Ligën 1. Kante ka bërë 48 paraqitje për "Blutë e Londrës" sezonin që lamë pas, duke realizuar një gol.

#### Arrihet marrëveshja, Mahrezi te City

Manchester City dhe Leicester City kanë arritur ta gjejnë marrëveshjen për transferimin e Riyad Mahrez për shumën e 85 milionë eurove. Sipas dy gazetave më të mëdha në ishull, "The Sun" dhe "Mirror", marrëveshja është arritur dhe mungon vetëm zyrtarizimi, kështu që Mahrezi do ta kurorëzojë ëndrrën për të luajtur me Manchester Cityn e Guardiolas. Mahrezi bëri 36 paraqitje në Premier Ligë sezonin që lamë pas, duke shënuar 12 gola.





**Specific Procurement Notice**


**Procurement Consultant- RCQ-MFK- 004**

The Government of Kosovo has received grant funding of UD\$49,000,000.00 (Forty-Nine Million United States Dollars) from the Millennium Challenge Corporation (MCC) of the United States Government to support Kosovo through a Threshold Program which is designed to lower energy costs for households and businesses and to support the Government of Kosovo in its efforts to improve data transparency to spur growth, fight poverty and advance stability.

The Millennium Foundation of Kosovo (MFK), the Accountable Entity created by the Government of Kosovo to implement this program and achieve the objectives of the MCC Grant Agreement, intends to apply parts of the proceeds of the funds to payments for Contracts for Goods, Works and Services.

To support this project MFK is seeking one (1) full time Procurement Consultant (Individual Consultant) to support the project.

Applications submission deadline: 20 June 2018, 11: 00am local time. Interested eligible consultant may refer to the other relevant documents (RCQ/TOR) at: [millenniumkosovo.org](http://millenniumkosovo.org)



**Lume's Details**

**Estetik & Depilim**

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

[lumesdetails](#)

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



**Shijo Pranverën me...**

**Jaffa Champion PLUS A+C+E Multifrutti**

Taste of World Wide Brand!

**Jaffa Champion**





KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A, në Prizren

## NJOFTON

Kompania Rajonale e Ujësjetës "Hidroregjioni Jugor" Sh.A me seli në Prizren **anulon** Konkursin për plotësimin e vendit të punës: **Inkasant-1** në Njësinë punuese Prizren e shpallur me datën 15.05.2018, në shtypin ditor "Epoka e Re".

Kompania Rajonale e Ujësjetës  
"Hidroregjioni Jugor" Sh.A Prizren

## OBAVESTENJE

Regionalna Kompanija za Vodovod "Hidroregjioni Jugor" D.D. u Prizrenu **ponistava** konkurs za popunu radnog mesta: **Inkasant-1** u Radnoj jedinici Prizren i koji je objavljen dana 15.05.2018 u dnevnoj stampi "Epoka e Re".

Regionalna Kompanija za Vodovod  
"Hidroregjioni Jugor" D.D. Prizren



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administratës Publike  
Ministarstvo Javne Uprave - Ministry of Public Administration

## VAZHDIM I KONKURSI

Ministria e Administratës Publike zgjat afatin për shtatë ditë kalendarike për aplikim të kandidatëve në Konkursin për pozitën, Sekretar i Përgjithshëm në, Ministrinë e Integritimit Evropian, të shpallur më datë 26.05.2018, për arsye se nuk është arritur numri i balancuar i aplikacioneve nga aspekti etnik dhe gjinor.

## PRODUZEN KONKURS

Ministarstvo Javne uprave produžava rok za sedam kalendarski dana za aplikaciju kandidata na konkursu za poziciju, Generalni Sekretar u Ministarstvo za Evropske Integracije, objavljen dana 26.05.2018 za to što nije postignut balancirani broj aplikacija sa etničkog i polnom aspekta.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.38/16

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Malsor Kryeziu, me sekretaren juridike të kësaj Gjykate, Drita Haxhishabani, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Bahrije Gashi, nga Gjakova rr. "Ahmet Korenica" nr. 9 të cilën e përfaqëson i autorizuari Idriz Daci, avokat nga Gjakova, kundër të paditurës, Mrika (Pal) Milici, nga Gjakova, rr. "Zeki Shehu" nr.7 tani me banim të përkohshëm jashtë vendit, me adresë të panjohur, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë - ekzekutimin e kontratës mbi shitblerje të paluajtshmërisë, vlera e kontestit 500 euro, me date 15.01.2018, mori këtë:**

### AKTVENDIM

I. Të paditurës Mrika (Pal) Milici, nga Gjakova, rr. "Zeki Shehu" nr.7 tani me banim të përkohshëm i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor të cilat i ushtron deri sa të paraqitet në gjykatë e paditura apo përfaqësuesi i saj me prokuror, gjegjësisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftojë gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

II. Në kuptim të nenit 82 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor të cilat i ushtron deri sa të paraqitet në gjykatë e paditura apo përfaqësuesi i saj me prokuror, gjegjësisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftojë gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

III. Ky aktvendim do të shpallet në gazetën zyrtare, në një nga gazetatat e përditshme ditore si dhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës.

### Arsyetim

Paditësja Bahrije Gashi, nga Gjakova rr. "Ahmet Korenica" nr. 9 të cilën e përfaqëson i autorizuari Idriz Daci, avokat nga Gjakova, pranë kësaj gjykate ka parashtruar paditje për vërtetimin e të drejtës së pronësisë - ekzekutimin e kontratës mbi shitblerje të paluajtshmërisë kundër të paditurës Mrika (Pal) Milici, nga Gjakova, rr. "Zeki Shehu" nr.7 tani me banim të përkohshëm jashtë vendit, me adresë të pa njohur, me propozim për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm.

Gjyqtari pas vlerësimit të shkresave të lëndës dhe duke pasur parasysh se procedura për caktimin e përfaqësuesit ligjor do të zgjatë shumë, e në anën tjetër do të shkaktohen dëme të pa nevojshme palës paditëse e me qëllim të evitimit të pasojave të dëmshme gjykata i caktoj avokatin Teki Bokshi, nga Gjakova-përfaqësues i përkohshëm për të paditurën Mrika (Pal) Milici, gjersa ai apo i autorizuari i saj të paraqitet në këtë gjykatë apo gjersa organi i kujdestarisë të njoftojë se ka caktuar kujdestarin.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi konfirmim dispozitave të nenit 79.3 pika a) dhe b) të Ligjit të Procedurës Kontestimore, Nr.03/L-006, 30 qershor 2008.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË  
C.nr.38/16 të datës 15.01.2018



## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Kompani "Makcar" L.L.C. shpallë të humbur certifikatën e regjistrimit të biznesit me numër 70619911 si dhe numrin fiskal me nr. 600421151

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshohet me qira banesën tri dhomshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektesë si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshohet banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

► Lëshohet banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkohet kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

► Lëshohet banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshohet banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afatë të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasensas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



## AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla  
"RITMO - L"  
Prishtinë**

**Eksperienca jonë  
- përfitimi i juaj.**

**Afati i paraqitjes prej 03.03.2018  
deri më 10.03.2018**

**Ju mirëpret:**

**Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:**

**044 248 173**

**044 200 604**

**044 375 333**